

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7165
E mërkurë, 17 prill 2024
Çmimi 0.50 €

Haxhiu pas takimit me krerët
e sigurisë dhe të drejtësisë:
Neglizhenca nga shteti po i
kthen dhunuesit në vrasës

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", VLORA ÇITAKU

SJELLJA E KURTIT ME ALEATËT ËSHTË E RREZIKSHME, VENDI TË SHKOJË NË ZGJEDHJE

FAQE 4-5

- Mbështetja për
kandidaturën e
Bedri Hamzës
për kryeministër
tejkalon kufijtë
e PDK-së



Sekretarja e përgjithshme e Partisë Demokratike të Kosovës, Vlora Çitaku, ka thënë se Kosova e udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti ka bërë vetëm hapa prapa në politikën e jashtme dhe të brendshme. Çitaku në këtë intervistë dhënë "Epokës së re" ka thënë se sjelljet e Kurtit në raport

me aleatët janë të rrezikshme për Kosovën. Ajo ka kërkuar që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare. Çitaku ka bërë me dije se PDK-ja do të ndërmarrë veprime konkrete në Kuvendin e Kosovës për ta çuar vendin në zgjedhje. Ajo është shprehur e bindur se PDK-ja do të

dalë fituese e këtyre zgjedhjeve dhe se Kosova do të drejtohet nga Bedri Hamza. Në këtë intervistë Çitaku ka drejtuar akuza ndaj drejtuesve institucionale sa i përket procesit gjyqësor në Hagë. Ajo ka thënë se Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi janë braktisur nga shteti

BASHKËSHORTI VRET GRUAN
NË PEJË, VRASJA DËNOHET
NGA INSTITUCIONET F. 6



BE-ja
KUSHTËZON
INTEGRIMIN E
SERBISË PËR
NORMALIZIMIN
E RAPORTEVE
ME KOSOVËN F. 7



GUVERNATORI I BQK-së ZOTOHET
PËR FORCIMIN E POLITIKËS SË
INVESTIMEVE NË PËRPUHJE ME
PRAKTIKAT NDËRKOMBËTARE F. 8

MINISTRI MURATI UDHËTON PËR NË
SHBA F. 8

SPORT



LLAPI 'KËRCËNON' FFK-në: NËSE
DELEGOHET VISAR KASTRATI NUK
DO TË DALIM NË FUSHË F. 12

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Boltoni: Një përgjigje e fuqishme nga Izraeli ndaj Iranit do të ishte e justifikueshme



WASHINGTON, 16 PRILL - Ish-këshilltari për siguri kombëtare të Shteteve të Bashkuara, John Bolton, tha se Izraeli ka të drejtë t'i kundërpërgjigjet Iranit për shkak të sulmit që Teherani kreu gjatë fundjavës, përfshirë edhe shkatërrimin e programit të tij bërthamor, duke shtuar se ai qëndron pas deklaratës së tij se "është e turpshme" që presidenti amerikan, Joe Biden, i bëri thirrje Izraelit të mos përgjigjet.

Në një intervistë për Radion Evropa e Lirë, Boltoni tha se nëse Irani do të shënjestronte ShBA-në duke përdorur qindra raketa balistike, raketa lundruese dhe dronë, siç bëri më 13 prill kundër Izraelit, Uashingtoni do të kundërpërgjigjej minimalisht duke ia shkatërruar bazat dhe ndërtesat nga të cilat u nisën sulmet. "Jam i bindur që nëse ShBA-ja do të përballej me një sulm të tillë, nuk kam asnjë dyshim se çfarë do të bënim. Pse duhet t'ua mohojmë të drejtën izraelitëve... të veprojnë në mënyrën e njëjtë siç do të vepromin ne?".

Bolton foli me REL-in nga Uashingtoni në kohën kur Izraeli po mendon se si t'i përgjigjet

sulmit të Iranit. Teherani tha se e kreu sulmin në kundërpërgjigje të një sulmi të dyshuar ajror në ndërtesën e Ambasadës iraniane në Damask të Sirisë muajin e kaluar, ku u vranë dy gjeneralë. Pothuajse të gjitha raketat dhe dronët u rrëzuan nga sistemet ajrore izraelite apo u penguan nga forcat amerikane, franceze, britanike dhe jordaneze.

Bideni ka thënë se ai dëshiron ta parandalojë zgjerimin e konfliktit në Lindjen e Mesme dhe ka bërë thirrje për kujdes, duke i thënë Izraelit të "mendojë me kujdes dhe në mënyrë strategjike" para se t'i përgjigjet Iranit, që do të mund të çonte në një konflikt më të gjerë.

Por, Boltoni tha se për shkak se Izraeli mund të mos jetë i sigurt që raketat e ardhshme balistike të lëshuara nga Irani nuk do të përmbajnë koka bërthamore, është në interesat afatgjatë të Izraelit që ta shqyrtojë mundësinë e një reagimi për ta shkatërruar programin bërthamor të Iranit. Dhe nëse Izraeli do të vendosë të veprojë kështu, ShBA-ja duhet ta mbështesë, tha ai.

Sulmi i 13 prillit ka rritur frikën për një përshkallëzim tjetër të madh

të luftimeve në Lindjen e Mesme dhe rreziqet janë të larta për shkak se "ne jemi në territor të paeksploruar", tha Michael Horowitz, kreu i inteligjencës në kompaninë konsulente "Le Beck" me seli në Bahrein.

Një luftë në shkallë të plotë është skenari më i keq që mund të shkaktohet nga një sulm izraelit ndaj ndërtesave bërthamore në Iran, tha Horowitz, në një intervistë dhënë për REL-in më 15 prill. "Nëse ne arrijmë në këtë pikë, mund të shohim javë të tëra sulmesh izraelite në Iran, angazhim në shkallë të plotë të Hezbollahut në një sulm ndaj Izraelit, dhe një pushtim tokësor izraelit në Liban si dhe mund të shohim një përpjekje iraniane për ta mbyllur Gjirin Persik", tha Horowitz.

Tani rajoni është "më afër një skenari të tillë se kurrë më parë" edhe nëse nuk ka ndonjë shkakter specifik, një cikël i sulmeve midis Iranit dhe Izraelit "mund të na çojë në atë skenar, nëse palët e jashtme nuk veprojnë, siç kanë bërë deri më tani, për t'i ulur tensionet".

Boltoni ka shkruar librin me titullin "Dorëzimi nuk është

opsion: Mbrojtja e Amerikës në Kombet e Bashkuara", pasi përfundoi mandatin si ambasador i ShBA-së në OKB nga gushti i vitit 2005 deri në dhjetor të vitit 2006. Si nënsekretar i Shtetit për kontrollin e armëve dhe sigurinë ndërkombëtare nga viti 2001 deri më 2005, ai kishte avokuar për masa më të ashpra kundër programeve bërthamore të Iranit dhe Koresë së Veriut.

Boltoni tha se Izraeli veçse është i përfshirë në luftë në Gazë kundër Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian - dhe është sulmuar në veri nga Hezbollahu.

Për më tepër, tha ai, rebelët Huthi në Jemen, të mbështetur nga Irani, kanë sulmuar anijet ndërkombëtare në Detin e Kuq dhe ka pasur sulme të grupeve të lidhura me Iranin në Siri dhe Irak. Boltoni e akuzoi administratën Biden se po refuzon ta shohë konfliktin në Lindjen e Mesme në një kuptim strategjik. Ai tha se të gjitha grupet terroriste që operojnë në rajon janë të armatosura, të pajisura, të trajnuara dhe të financuara nga

Irani prandaj, sipas tij, një përgjigje e fuqishme është e justifikueshme. "Irani është mjeshhtë i marionetave. Kjo është një luftë e gjerë në të cilën veçse jemi", tha ai për REL-in. "Këto nuk janë beteja të ndara midis Izraelit dhe Hamasit në Gazë, apo rebelëve Huthi që tentojnë ta mbyllin Detin e Kuq dhe Kanalin e Suezit për anijet tregtare ndërkombëtare. E gjithë kjo kontrollohet nga Irani", shtoi ai. Ai mbrojti kritikën e tij ndaj Bidenit, që tha se reagimi i tij ishte "i turpshëm", duke theksuar se një luftë më e gjerë që administrata amerikane dhe të tjerët drujnë ka nisur më 7 tetor, në ditën kur Hamasit sulmoi Izraelin, duke rrëmbyer afër 250 pengje e duke vrarë afër 1 200 të tjerë. Më shumë se 100 pengje ende po mbahen nga radikalët palestinezë.

Boltoni, i cili për 17 muaj ishte këshilltar i ish-presidentit Donald Trump, tha se ai nuk mund të parashikojë se si mund të dukej një përgjigje e Izraelit, por tha se kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu, e di kërcënimin bërthamor të Iranit "më mirë se kushdo tjetër në Izrael, të jem i sinqertë, edhe në ShBA".

Nëse do të detyrohej të parashikonte, ai tha se përgjigja mund të jetë "e nivelit të ulët" dhe mund të ndodhë brenda ditësh.

Boltoni ishte këshilltari i tretë i Trumpit për siguri kombëtare, të cilin iu kërkua dorëheqja në shtator të vitit 2019 pas muajsh të mendimeve ndryshe lidhur me drejtimin e politikës së jashtme amerikane dhe të sigurisë kombëtare.

Një vit më vonë Boltoni shkroi një libër lidhur me mandatin e tij në Shtëpinë e Bardhë. Publikimi i librit "Dhoma ku ndodhi: Memoari i Shtëpisë së Bardhë" zemëroi Trumpin, pasi në të ai u portretizua si person injorant sa iu përket fakteve themelore të geopolitikës. Shtëpia e Bardhë kishte tentuar ta ndalte publikimin e librit, por një gjykatës kishte refuzuar këtë kërkesë. Trumpi kishte reaguar pas publikimit të librit, duke e quajtur Boltonin "të paaftë" dhe "një budalla të mërzhitshëm".

Ukraina ia rrëzon nëntë dronë Rusisë

KIEV, 16 PRILL - Sistemet kundërajrore ukrainase i kanë rrëzuar të gjithë nëntë dronët që Rusia i lëshoi në drejtim të territorit të Ukrainës mëngjesin e së martës, njoftoi Forca Ajrore e Ukrainës.

Dronët u shkatërruan mbi rajonet Herson, Mikolaiv, Hmelnitki, Poltava, Çerkasi dhe Dnipropetrovsk, tha ajo në

një njoftim.

Në javët e fundit Rusia i ka rritur dukshëm sulmet kundër infrastrukturës energjetike të Ukrainës pasi forcat ukrainase janë duke u përballur me mungesë të sistemeve kundërajrore dhe të municionit.

Ndihma e shumëveojshme amerikane për Kievin ka

ngesur në Dhomen e Përfaqësuesve për shkak të kundërshtimeve nga republikanët.

Më 14 prill ministri i Jashtëm ukrainas Dmytro Kuleba u bëri thirrje aleatëve perëndimorë të Kievit që në mënyrë "urgjente" t'i dërgojë sisteme shtesë të mbrojtjes ajrore, armë dhe municion.



Konjufca: Kuvendi është hapësira e duhur për ngritjen e zërit dhe kauzave për barazi gjinore

PRISHTINË, 16 PRILL - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca mori pjesë në Forumin Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, i cili për të dytin vit po mbahet në Prishtinë.

Me këtë rast, Konjufca shprehu indinjatën e tij rreth ngjarjes së vrasjes së një gruaje sot në Pejë, kur edhe para disa ditëve një tjetër ngjarje e tillë e rëndë kishte ndodhur në Ferizaj, duke shtuar se në shumicën e këtyre rasteve vrasjet janë kryer nga burra që kanë pasur vepra penale sa i përket dhunës në familje.

Kryeparlamentari Konjufca kërkoi konsolidim të mekanizmave të sigurisë dhe gjyqësisë që raste të vrasjes së grave mos të ndodhin më.

Duke folur për rëndësinë e Forumit Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, kryetari tha se këtë edicion e bën edhe më domethënës periudha kohore në të cilën po mbahet, pra në javën kur Kosova shënon ditën që i kushtohet të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë.

Me këtë rast, kryetari Konjufca kërkoi që autorët e këtyre krimeve çnjerëzore të vihen para drejtësisë. "Rreth 20 mijë gra u dhunuan gjatë luftës në Kosovë e këto janë dëshmia e dhimbjes sonë të vazhdueshme dhe kujtimeve të tmerrshme, me të cilat populli ynë vazhdon të jetojë çdo ditë. Përveç dhimbjes që i ka përcjellë tash e 25 vite, ato përballen edhe me stigmën shoqërore dhe mungesën e padurueshme të drejtësisë, përderisa kryerësit e këtyre krimeve nuk e kanë marrë dënimin e merituar dhe shumica prej tyre janë të lire", tha kryetari Konjufca.

I pari i Kuvendit potencoi se Kuvendi i Republikës së Kosovës vitin e kaluar e ka miratuar ligjin përkatës, me anë të të cilit zgjatet afati për aplikim për njohjen e statusit të viktimës së dhunës seksuale të luftës, deri më 15 maj 2025.

Kryetari i Kuvendit duke folur për paqen dhe sigurinë në nivel botëror tha se krizat dhe vatrat e luftës ndikojnë më së shumti në jetën e grave dhe vajzave.



I pari i legjislavitit përgëzoi iniciativën e presidentes Vjosa Osmani për themelimin e Qendrës së Ekselencës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, zotim ky që është marrë edhe në Samitin për Demokraci.

Duke folur rreth përpjekjeve për demokratizimin e rolit të grave dhe vajzave, kryetari Konjufca tha se Kuvendi është hapësira e duhur për ngritjen e zërit dhe kauzave për barazi gjinore, për pjesëmarrjen e grave dhe rolin e

tyre thelbësor për ta zhvilluar demokracinë parlamentare. "Kontributi ynë në reforma ligjore, sidomos në legjislacionin që drejtpërdrejt i prek objektivat e kësaj agjende, është prioriteti ynë", tha kryetari Konjufca.

Haxhiu pas takimit me krerët e sigurisë dhe të drejtësisë: Neglizhenca nga shteti po i kthen dhunuesit në vrasës

PRISHTINË, 16 PRILL - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, në një konferencë për medie të martën, ka folur rreth vrasjeve të fundit të grave në Kosovë. Haxhiu ka thënë se me mosveprime dhe neglizhencë nga institucionet e drejtësisë shteti vetë po i shndërron dhunuesit në vrasës.

Pas takimit që pati me institucionet e sigurisë dhe drejtësisë për shkak të rritjes së numrit të vrasjeve të grave në Kosovë, Haxhiu u ka bërë thirrje institucioneve të drejtësisë që rastet e dhunës në familje t'i trajtojnë me prioritet. "Institucionet e drejtësisë të veprojnë brenda kompetencave dhe mekanizmave që kanë në dispozicion, duke mos neglizhuar as edhe një rast të vetëm të dhunës në familje. Kur po kemi raste të neglizhencave, të



mosveprimeve, shteti vetë po e shndërron dhunuesin në vrasës", ka thënë ajo.

Haxhiu tha se që nga paslufta e deri më sot 99 gra janë vrarë nga bashkëshortët e ish-bashkëshortët. "Është brengosëse dhe tejet alarmante që e shohin dhunën si mjet të rëndomtë për tejkalimin e problemeve të cilat tashmë shpesh herë po përfundojnë me fatalitet, pra me vrasjen e grave nga burrat e tyre apo nga ish-bashkëshortët. Ky fenomen është armiku ynë i brendshëm me rrezik të madh. Këto sjellje barbare dhe këto akte monstruoze shkatërrojnë jo vetëm jetën e viktimave, por edhe familjet e tyre dhe të shoqërisë. Nga viti 1999, që prej kur me entuziazëm po prisnim ngritjen e Kosovës pas çlirimit e deri më sot, Kosova shënon 99 gra të vrara nga burrat", ka thënë Haxhiu.

Presidenti i Shqipërisë viziton familjen e ish-presidentit Rugova

PRISHTINË, 16 PRILL - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj, gjatë qëndrimit në Kosovë zhvilloi një vizitë në familjen e presidentit të ndjerë të Kosovës, Ibrahim Rugova. Ai u prit nga familjarët e ish-presidentit Rugova, bashkëshortja Fanë, e bija, Teuta, dhe nga i biri, Ukë Rugova, me të cilët zhvilloi një bisedë vëllazërore për familjet,

zhvillimet në Prishtinë e Tiranë, si dhe të ardhmen e shqiptarëve. Begaj kujtoi figurën emblematike të Rugovës dhe u shpreh se mësimet e tij, urtësia, mençuria dhe vizioni i burrit të rezistencës humane duhet të nderohen dhe ndiqen nga shqiptarët në çdo kohë. "Çdo shqiptar duhet të vijë këtu, pasi për të gjithë ne Rugova do të mbetet dhe është president", u

shpreh Begaj, i cili e vlerësoi Rugovën si lider vizionar, udhërrëfyes dhe një shembull frymëzimi për të gjithë shqiptarët. "Kombi shqiptar nuk do të ishte këtu ku ndodhet pa kontributin e jashtëzakonshëm të Ibrahim Rugovës. Ëndrra e kamotshme e krejt shqiptarëve u realizua", vlerësoi presidenti Begaj gjatë takimit me familjen Rugova.





FLET PËR "EPOKËN E RE", VLORA ÇITAKU

Sjellja e Kurtit me aleatët është e rrezikshme, vendi të shkojë në zgjedhje

- Mbështetja për kandidaturën e Bedri Hamzës për kryeministër tejkalon kufijtë e PDK-së

Sekretarja e përgjithshme e Partisë Demokratike të Kosovës, Vlera Çitaku, ka thënë se Kosova e udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti ka bërë vetëm hapa prapa në politikën e jashtme dhe të brendshme. Çitaku në këtë intervistë dhënë "Epokës së re" ka thënë se sjelljet e Kurtit në raport me aleatët janë të rrezikshme për Kosovën. Ajo ka kërkuar që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare. Çitaku ka bërë me dije se PDK-ja do të ndërmarrë veprime konkrete në Kuvendin e Kosovës për ta çuar vendin në zgjedhje. Ajo është shprehur e bindur se PDK-ja do të dalë fituese e këtyre zgjedhjeve dhe se Kosova do të drejtohet nga Bedri Hamza. Në këtë intervistë Çitaku ka drejtuar akuza ndaj drejtuesve institucionalë sa i përket procesit gjyqësor në Hagë. Ajo ka thënë se Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi janë braktisur nga shteti

EPOKA E RE

Lirim GEÇI

PRISHINË, 16 PRILL -

"Epoka e re": Znj. Çitaku, si i vlerësoni zhvillimet politike dhe të sigurisë në Kosovë nga këndi i partisë më të madhe opozitare?

Çitaku: Fatkeqësisht jo vetëm në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë, por në çdo sferë relevante për kualitetin e jetës të qytetarëve dhe për fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, Kosova ose ka qëndruar në vendnumërim në rastin më të mirë ose, fatkeqësisht, ka bërë hapa prapa. Sot, kur jo vetëm kontinenti evropian, por i tërë globi është duke u ballafaquar me sfida të jashtëzakonshme, Kosova, për shkak të udhëheqës së

kryeministrit Kurti, shoqëria është më e polarizuar se kurrë nga brenda dhe raportet me aleatët kryesorë janë më të cenuara se asnjëherë më parë. Çfarë është e rëndësishme për një shtet relativisht të vogël siç është Kosova, por jo vetëm për shtete të vogla sepse sfidat nëpër të cilat është duke kaluar kontinenti ynë dhe bota me gjerë dëshmojnë më shumë dhe më qartë se aleancat janë po aq të rëndësishme sa edhe sovraniteti. Për shtetet si Kosova është shumë e rëndësishme që aleancat të mirëmbahen dhe të rreshtohemi drejt.

"Epoka e re": Në këtë kontekst, ku qëndron sot Kosova?

Çitaku: Kosova, fatkeqësisht, sot është nën sanksione të Bashkimit Evropian (BE) dhe tani më shumë

se dy vjet nuk kemi asnjë vizitë e asnjë takim të nivelit të lartë nga kryeministri apo nga ndonjë eksponentë qeveritar në Uashington D.C. Kjo situatë është alarmante dhe do të duhej të na shqetësonte të gjithëve.

"Epoka e re": Raportet me aleatët, a kanë qenë ndonjëherë më të këqija sesa në qeverinë e drejtuar nga Kurti?

Çitaku: Imagjinojeni para 25 vitesh UÇK-ja në rrethana tërësisht të pabarabarta dhe pakrahimisht më të vështira seç janë këto sot, kishte arritur të nënshkruante paktin e parë në mes të Kosovës dhe Perëndimit dhe arriti që fuqinë më të madhe politike dhe ushtarake ta ketë aleat. Ndërkohë që sot, në vitin 2024, ndonëse kemi shtet i pavarur e sovran dhe me më shumë se 100

njohje, Kosova, për shkak të sjelljes aventureske dhe të papërgjegjshme të kryeministrit Kurti, ka reduktuar deri në ekstrem ambicet e aleatëve tanë për Kosovën. Kjo qasje dhe kjo sjellje është jashtëzakonisht e rrezikshme. Kur një kryeministër flet me një lehtësi të padurueshme dhe etiketon sekretarin e Shtetit si naiv, më pas është tërësisht i paparashikueshëm në pikat të cilat janë të ndjeshme për aleatët tanë, siç është siguria dhe veriu i Kosovës, sigurisht që çon sinjale jo të duhura në Bruksel, Berlin, Londër, Paris dhe Uashington. Para pak ditësh presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka pritur kryeministrin e Shqipërisë dhe presidentin e Serbisë. Ku ishte Kosova? Mungoi.

"Epoka e re": Doni të thoni se kjo ka ndodhur për shkak të sanksioneve të BE-së?

Çitaku: Dhe jo vetëm për shkak të sanksioneve sepse kryeministri Kurti që nga dita e parë kur ka ardhur në pushtet ka demonstruar qasje shumë aventureske dhe të paparashikueshme. Kosova në koordinim me aleatët ka arritur t'i dëbojë forcat policore, ushtarake dhe administratën serbe nga Kosova, duke fituar lirinë. Në koordinim me aleatët ka arritur ta shpallë pavarësinë. Fatkeqësisht, për botëkuptimet dhe frymën

ideologjike të kryeministrit Kurti, bashkërendimi dhe koordinimi me aleatët nënkupton nënshtrim.

"Epoka e re": Vlerësoni se kryeministri Kurti është duke i bërë këto veprime me qëllim apo nga mosdija?

Çitaku: Koordinimi me ShBA-në nuk është nënshtrim. Koordinimi me aleatët nuk është nënshtrim. Koordinimi fuqizon Kosovën. Do të doja të besoja se Kurti është duke i bërë këto veprime nga mosdija edhe pse rezultati në fund fare është i njëjtë, pra është i dëmshëm për Kosovën. Mungesa e ekspertizës e ka karakterizuar këtë qeveri në çdo fushë. Ka mungesë të ekspertizës në politikë të jashtme, ekonomi, shëndetësi, arsim etj. Kësaj mungese të ekspertizës dhe kësaj qasje aventureske, PDK-ja i ka dhënë përballë eksperiencën dhe profesionalizimin. Ne besojmë se kandidati për kryeministër i PDK-së, Bedri Hamza, përfaqëson ofertën më serioze jo vetëm përballë kryeministrit Kurti, por ofertën më serioze për qytetarët tanë duke garantuar parashikueshmëri, stabilitet dhe zhvillim.

"Epoka e re": Znj. Çitaku, kur jemi të raportet e Kosovës, konkretisht të qeverisë Kurti me aleatët

ndërkombëtarë, ku është PDK-ja në këtë mes? Cili ka qenë roli i saj dhe a mendoni se ka luajtur mjaftueshëm këtë rol apo ka qenë indiferente?

Çitaku: PDK-ja ka bashkëpunim dhe kontakte të vazhdueshme me ShBA-në, Bashkimin Evropian (BE), me shtetet veç e veç brenda BE-së dhe më gjerë. Ne në mënyrë të vazhdueshme kemi kërkuar që Kosova mos të ndëshkohet për shkak të sjelljeve të papërgjegjshme të kryeministrit Kurti. Qeveria është e përkohshme, ndërsa Kosova është e përhershme dhe ne kemi kërkuar në çdo takim që Kosova dhe qytetarët e saj mos ta bartin koston dhe barrën e sjelljeve të papërgjegjshme dhe aventureske të kryeministrit. Ne ende vazhdojmë të llobojmë dhe të kërkojmë në çdo takim që masat ndëshkuese t'i hiqen Kosovës sa më parë sepse ne vlerësojmë që dëmi këtu i shkon Kosovës dhe qytetarëve dhe jo Albin Kurtit. Në fund të fundit, kryeministri Kurti dhe partia e tij nuk është që shquhen për ndonjë interesim apo mirëmbajtjen e aleancave. Unë e mbaj mend që kur kam qenë ministre për Integritet Evropian, partia e vetme që nuk e ka votuar Marrëveshjen për Stabilizim Asociim (MSA) ka qenë pikërisht Lëvizja Vetëvendosje. Kështu që unë mendoj që në fund të ditës, atyre nuk u bëhet shumë vonë se a është Kosova nën masa.

"Epoka e re": Kur jemi te sjelljet e qeverisë dhe kryeministrit Kurti, shihni ndonjë rrezik se mund t'i kushtojë Kosovës kur tashmë jemi në fazën e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës?

Çitaku: Ne besojmë se Kosova do ta kalojë suksesshëm edhe këtë fazë sepse kjo fazë është në dorën e Asamblesë Parlamentare ku ne tash e shumë vite kemi votat e nevojshme për të kaluar në fazën tjetër. Në këtë fazë nuk përfundon procesi i anëtarësimit të Kosovës në KE, por vetëm kalohet një hap shumë i rëndësishëm. Procesi më vendimtar do të jetë ai në muajin maj ku do të takohen ministrat dhe aty do të merret vendimi se si do të procedohet tutje. Çdo anëtarësim i Kosovës në organizatat ndërkombëtare është bërë me ndihmën e aleatëve tanë dhe unë shumë po shpresoj se në këto pak javë që kanë mbetur, kryeministri dhe qeveria do të këndellen dhe do t'i bashkërendojnë raportet me aleatët.

"Epoka e re": A prisni që Kosovës t'i vihet ndonjë kusht i ri për anëtarësim në KE, e kam fjalën për dërgimin e statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Gjykatën Kushtetuese?

Çitaku: Nga aleatët tanë është thënë në mënyrë eksplicite dhe jo vetëm tani, por në vazhdimësi, që Kosova duhet t'i respektojë vendimet e Gjykatës Kushtetuese sepse janë vendime të institucioneve të pavarura të Republikës së Kosovës, ngjashëm me vendimin për pronat e manastirit të Deçanit. Ndërkohë në mënyrë eksplicite kam dëgjuar të jetë kërkuar çështja e Asociacionit, pra ndërlidhur me procesin në Këshillin e Evropës, por kjo nuk do të thotë se vende anëtare brenda KE-së nuk do ta kushtëzojnë votën e tyre lidhur me Asociacionin.

"Epoka e re": Znj. Çitaku, të ndalemi pak edhe te politika e brendshme e Kosovës. Si e keni parë qeverisjen e qeverisë Kurti gjatë këtyre viteve?

Çitaku: Ajo çfarë kemi parë në këto katër vjet, qeverisja është në vendnumërim në rastin më të mirë dhe kthim mbrapa në rastin më të keq. Është shumë e qartë se kryeministri Kurti nuk dëshiron të qeverisë. Kryeministri Kurti dëshiron të nënshtrojë. Ai dëshiron t'i nënshtrojë mediet, sektorin privat, bizneset, sindikatat, arsimtarët, mjekët etj. Mirëpo, Kosova dhe ky popull nuk nënshtrohen. Unë besoj se zgjedhjet e ardhshme do të jenë një mundësi për ta rikalibruar sërish peizazhin politik në Kosovë dhe për t'i dhënë fund një mendësi qeverisëse, e cila bashkëpunimin edhe mes nesh, por edhe me aleatët, e sheh si nënshttrim. Qeveria Kurti edhe kompromisin shoqëror e sheh si nënshttrim. Ne kemi nevojë për dialog social. Ne kemi nevojë të flasim me njëri-tjetrin. Sa iu përket projekteve, nuk mund ta përmend një të vetëm, qoftë në fushën e rendit dhe ligjit, qoftë në fushën e zhvillimit ekonomik, qoftë reformave në arsim apo shëndetësi, etj. Pra, nuk mund ta gjeni një projekt të vetëm që ka filluar apo realizuar nga kjo qeveri.

"Epoka e re": Por, qeveria është duke e thënë të kundërtën, madje vazhdimisht duke publikuar statistika...

Çitaku: Statistikat e vërteta janë aeroportet dhe stacionet e autobusëve.

"Epoka e re": kryeministri Kurti ka deklaruar se më shumë qytetarë janë duke u kthyer në Kosovë sesa duke u larguar...

Çitaku: E kam dëgjuar deklaratën e tij, në fakt e kam lexuar dhe më është dashur ta gjej dhe ta dëgjoj me veshët e mi për ta besuar, sepse ajo deklaratë me lë të kuptojë se kryeministri është duke jetuar në një univers paralel të shkëputur tërësisht nga realiteti në Kosovë.

"Epoka e re": Si do ta përmbledhni punën e qeverisë Kurti?

Çitaku: Unë do të thosha nëse ka vetëm një gjë të mirë nga ky mandat qeverisë është demistifikimi i figurës së Albin Kurtit.

"Epoka e re": Në kontekst të politikës së jashtme dhe të brendshme, si e keni parë rolin e presidentes



Osmani?

Çitaku: Fatkeqësisht, në disa momente vendimtare, posaçërisht për raportet e Kosovës me aleatët, sepse funksioni i presidentes është bartës i politikës së jashtme. Presidentja ka dështuar të flasë qartë, hapur dhe publikisht për çështje jashtëzakonisht të rëndësishme dhe vitale. Sigurisht, ne po marrim sinjale se qëndrime të ndara po jep në takime, mirëpo kjo nuk mjafton. Presidentja ka ditur të jetë shumë më e zëshme dhe, fatkeqësisht, meqë është në pozitë e kemi parë shumë më të heshtur edhe atëherë kur nuk do të duhej të ishte.

Mbështetja për kandidaturën e Bedri Hamzës për kryeministër tejkalon kufijtë e PDK-së

"Epoka e re": Znj. Çitaku, PDK-ja para disa ditësh ka bërë disa ndryshime brenda strukturës drejtuese si dhe ka paraqitur kandidatin për kryeministër për zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Në këtë drejtim ku është PDK-ja sot?

Çitaku: PDK-ja është çdo ditë në terren, në bashkëbisedim me qytetarët anekënd, në fshatra dhe qytete. Jemi në bashkëbisedim me grupe të ndryshme, me mjekë, mësimdhënës dhe shoqërinë civile. Jemi duke punuar në projektin qeverisë që do të udhëhiqet nga kryeministri i ardhshëm i Kosovës, Bedri Hamza. Ne këtë vit hyjmë në proces zgjedhor dhe kërkojmë që

zgjedhjet të mbahen sa më parë. PDK-ja hynë në këtë proces zgjedhor me bindje të plotë që do të dalim fitimtarë.

"Epoka e re": Në çfarë e bazoni optimizmin se do të dilni fitues të zgjedhjeve përderisa nga partia në pushtet thuhet se gara do ta zhvillohet për vendin e dytë në mes të PDK-së dhe LDK-së?

Çitaku: Arrogancë të tillë partia në pushtet pati demonstruar edhe në zgjedhjet lokale dhe përfundoi me katër komuna. Kështu që ne nuk po flasim pa matje dhe matja më e mirë është dalja në terren dhe bashkëbisedimi me qytetarë të cilët janë të zhgënjyer me qeverinë Kurti. Ne jemi shumë të bindur se rezultati do të jetë ndryshe, pra në favor të PDK-së. Dhe nëse Lëvizja Vetëvendosje është aq konfidente, atëherë pse nuk është duke e pranuar kërkesën e PDK-së që të shkojmë në zgjedhje. Në fakt, kryeministri Kurti njëherë tha do të shkojmë në zgjedhje kur të dëshirojë opozita, e tash si duket është kthyer disa hapa prapa.

"Epoka e re": A keni pasur ndonjë iniciativë që ta shtyni përpara datën të cilën e keni kërkuar që të mbahen zgjedhjet?

Çitaku: Kërkesa jonë është që zgjedhjet të mbahen më 9 qershor, por ne e dimë se si PDK dhe si një nga partitë parlamentare, ndonëse më e madhja në opozitë, nuk e kemi monopolin mbi përcaktimin e datës së zgjedhjeve. Jemi ta hapur të diskutojmë për një modalitet rreth

të cilit pajtohemi të gjithë.

"Epoka e re": A do të ndërmerreni ndonjë iniciativë konkrete sa i përket shkuarjes në zgjedhje të parakohshme?

Çitaku: Po. Do të ketë iniciativa konkrete në Kuvendin e Kosovës, por ne nuk duam ta befasojmë askënd sepse kjo në fund fare nuk është një përpjekje e kotë për bajraktarizëm as për ta marrë flamurin. Ne do të bashkëbisedojmë. Kemi pasur disa takime, por do të vazhdojmë edhe në të ardhmen dhe do të dalim me një nismë në Kuvendin e Kosovës.

"Epoka e re": Ju thoni se vazhdimisht jeni në terren. Si është pritur kandidatura e Bedri Hamzës për kryeministër?

Çitaku: Mund të them se ka një frymë jashtëzakonisht pozitive dhe një mbështetje që i tejkalon kufijtë e PDK-së. Katër vjet aventurë, presion dhe duket se e kanë lodhur qytetarin e Kosovës dhe duket se ata me padurim presin një kryeministër serioz, i cili garanton stabilitet, prashikueshmëri dhe zhvillim. Të gjitha këto i garanton figura e Bedri Hamzës.

Liderët e UÇK-së në Hagë janë braktisur nga shteti

"Epoka e re": Znj. Çitaku, është bërë më shumë se një vit nga nisja e procesit gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së në Hagë. Si jeni duke e parë këtë proces?

Çitaku: Ajo çfarë është e evidente është se në atë tavolinë të gjyqimit nuk janë emrat e përveçëm. Aty është historia jonë. Fatkeqësisht, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi. Ne nuk i ndajmë. Janë atje të braktisur nga shteti dhe nga institucionet e Kosovës.

"Epoka e re": Në çfarë aspekti janë të braktisur nga shteti?

Çitaku: Nuk u ofrohet ndihma e nevojshme dhe e domosdoshme jo vetëm financiare, por edhe politike dhe publike, pa ndërhyrë në proces. Dy prej tyre në Hagë janë ish-kryetarë Kuvendi, njëri ish-kryeministër e ish-president dhe tjetri ish-deputet, të cilët janë atje jo si politikanë, jo si emra të përveçëm, por si liderë politikë të UÇK-së.



Shpërndahen fidanë të mjedrës dhe material përcjellës për fermerët e Gjilanit

GJILAN, 16 PRILL - Komuna e Gjilanit, përkatësisht Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë, ka shpërndarë fidanë të mjedrës dhe material përcjellës për ngritjen e pemishteve me mjedër.

Kryetari i komunës, Alban Hyseni, tha se 119 553.00 euro është vlera e 50.000 m² me mjedër dhe 20.000 m² me

boronicë që po i shtohen fondit të agronomisë në Gjilan. Ai tregoi se janë 19 fermerë përfitues për mjedër (me nga 10, 20 dhe 30 ari), duke përfshirë fidanët, sistemin pikë-pikë për ujitje, pompën e ujit 1.5kW, agrofolia, pompa spërkatëse 16 litër me bateri.

Kryetari më tej shtoi se 10

fermerë janë përfitues për boronicë (me nga 10, 20 dhe 30 ari), duke përfshirë fidanët, vazot, substratin, agrofolia, sistemi pikë-pikë për ujitje, pompën e ujit 1.5kW dhe pompa spërkatëse 16 litër me bateri. “Kjo po bëhet për bujqësinë, për fermerët, punëtorët e vërtetë e të sinqertë”, tha kryetari Hyseni.

Bajram Isufi, drejtor i Bujqësisë dhe Pylltarisë, tha se po vazhdojnë mbështetjen ndaj fermerëve. Sipas tij, janë 5 hektarë që do të mbillen me mjedër. “19 fermerët e përzgjedhur janë me nga 20 ari e në raste të veçanta mund të përfitojnë edhe nga 10 ari dhe 30 ari”, tha Bajram Isufi. Drejtori i Bujqësisë dhe



Pylltarisë tha se për pemishten e mjedrës janë fidanët, komplet sistemi i ujitjes pikë-pikë, agrofolia, pompa e ujit 1.5 kw dhe pompa spërkatëse 16 litra me bateri.

Bashkëshorti vret gruan në Pejë, dënohet nga institucionet kjo vrasje

PEJË, 16 PRILL - Një grua është vrarë me armë zjarri nga bashkëshorti i saj në banesën e tyre në Pejë. Kështu ka konfirmuar Shkodran Nikqi, zëdhënës i Prokurorisë Themelore në Pejë.

Nikqi tha se i dyshuari është arrestuar dhe i është konfiskuar arma.

Instituti i Mjekësisë Ligjore ka tërhequr trupin e pajetë nga vendngjarja për t'i kryer ekzaminimet e nevojshme.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, gjatë pjesëmarrjes në një ngjarje në Prishtinë, dënoi vrasjen në Pejë, duke theksuar se të gjithë e kanë për detyrë t'i mbrojnë gratë dhe vajzat. “Fatkeqësisht, sot të gjithë jemi zgjuar në mëngjes me lajmin e tmerrshëm për vrasjen edhe të një gruaje nga bashkëshorti i saj. Ky fenomen i tmerrshëm që po e plagos shoqërinë dhe shtetin tonë, ky femicid i cili, për fat të keq, ka marrë përmasa të jashtëzakonshme, duhet të ndalet me çdo kusht. Dhe, mënyra e vetme për ta ndaluar atë është në qoftë se rizgjohe



të gjithë si shoqëri, si shtet e si komb. Rizgjohe mi sërish në këmbë kundër këtij fenomeni sepse nuk kemi jetë vajzash e grash për të humbur”, tha Osmani.

Presidentja Osmani tha se kjo ngjarje ndodhi një ditë pas nisjes së edicionit të dytë të Forumit për Gratë, Paqe dhe Siguri, ku u diskutua për dhunën ndaj grave. “U bëj thirrje të gjithëve, aktivistëve të shoqërisë civile, institucioneve të sigurisë e drejtësisë, qytetarëve, grave e burra bashkë, që ta ndalim një

herë e përgjithmonë dhunën mbi bazë gjinore që po e njollos shtetin tonë dhe mund ta shkatërrojë atë përbrenda”, shtoi Osmani.

Për vrasjen në Pejë reagoi edhe ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, e cila tha se, pavarësisht prej “masave të ndërmarra, fushatave të iniciuara me qëllim pikërisht barazisë gjinore, vrasjet ndaj grave po vazhdojnë”. Ajo tha se ka thirrur për sot një takim me ministrin e Punëve të Brendshme, kryesuesit e këshillave, ushtruesin e detyrës

së kryeprokurorit dhe drejtorin e Policisë së Kosovës dhe, “po ashtu, në një takim tjetër edhe mbledhjen e grupit ndërmintor” për ta trajtuar çështjen e vrasjes së grave. “Shpeshherë dhunuesit janë bërë vrasës pikërisht për shkak të mosndëshkimit adekuat nga institucionet përkatëse”, shkroi Haxhiu në “Facebook”.

Për këtë ngjarje ka reaguar edhe kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, i cili ka thënë se ky është alarmi që duhet ta zgjojë secilin person që ka sadopak përgjegjësi për ta garantuar sigurinë e qytetarëve e që, sipas tij, institucionet shtetërore kanë më së shumti. “Çfarëdo që është duke bërë aktualisht Qeveria e Kosovës nuk është më e rëndësishme sesa siguria e grave në Kosovë. Prandaj, i bëj thirrje që urgjentisht të krijohet një task-forcë me kompetenca të plota për mbrojtjen e grave nga dhuna dhe vrasjet”, ka shkruar Krasniqi.

Vrasja në Pejë është rasti i dytë brenda pesë ditësh në Kosovë kur gratë dyshohet se u vranë nga partnerët apo ish-partnerët

e tyre. Më 12 prill një 21-vjeçare u vra brenda zyrës së Qendrës për Punë Sociale në Ferizaj. Mediet raportuan se dorasi ishte ish-bashkëshorti i saj. Ndaj tij autoritetet kanë shqiptuar masën e paraburgimit prej një muaji.

Nga viti 2010 në Kosovë janë vrarë 57 gra.

Osmani e shpallë të mërkurën ditë zie shtetërore

Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, në mbështetje të Kushtetutës së Kosovës, ka marrë vendim që dita e mërkurë, 17 prill 2024, të shpallet ditë zie, në kujtim të të gjitha grave dhe vajzave të vrara në Kosovë si rezultat i dhunës në baza gjinore. Zija shtetërore do të jetë gjatë ditës së mërkurë, ndërkaq Protokolli i Shtetit ngarkohet t'i ndërmarret të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Shënohet 25-vjetori i të pagjeturve dhe martirëve në Mitrovicë

MITROVICË, 16 PRILL - Në “Shtëpinë Muze” që ndodhet në Lagjen e Boshnjakëve në veri të Mitrovicës, është shënuar Dita e të Pagjeturve dhe Martirëve, ku janë përkujtuar 116 të pagjeturit shqiptarë nga rajoni i Mitrovicës, si dhe 620 martirë të vrarë në luftën e fundit në Kosovë.

Në këtë aktivitet të pranishëm ishin nënkryetari i komunës, Arian Tahiri, drejtorë komunalë, kryetari i organizatës “Zëri i Prindërve”, Bajram Çerkini, familjarë të të pagjeturve e martirëve, përfaqësues



të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, si dhe qytetarë të

tjerë, të cilët me homazhe nderuan emrat e martirëve të

vendosur në pllakën përkujtimore.

Në fjalën e tij, nënkryetari Arian Tahiri ka thënë se muaji prill është muaji i dhimbjes dhe pikëllimit për të gjithë neve, e sidomos për familjarët e martirëve të cilët u vranë 25 vjet më parë në shtëpinë muze në Lagjen e Boshnjakëve. “25 vjet më parë në këtë shtëpi u vranë e u torturuan bashkëqytetarët tanë të cilët përjetuan dhunën dhe tmeririn, mirëpo sot ne gëzojmë lirinë dhe shtetësinë tonë falë luftës së lavdishme të UÇK-së.

Me respektin më të madh përulemi para të gjithë atyre që sakrifkuan për lirinë e vendit tonë. Lavdi dëshmorëve dhe të gjithë martirëve të luftës”, u shpreh nënkryetari Tahiri.

Kurse kryetari i organizatës “Zëri i Prindërve”, Bajram Çerkini, ka falënderuar qeverisjen lokale për bashkëpunimin e treguar për shënimin e kësaj dite me rëndësi për qytetarët e Mitrovicës. Pas kësaj ceremonie janë bërë homazhe dhe janë vendosur kurora me lule të “Shtëpia Muze”.

Funksionalizohet objekti i shkollës së parë shqipe në Ferizaj “Ismail Qemali”

FERIZAJ, 16 PRILL - Pas restaurimit nga Ministria e Kulturës, objekti i shkollës së parë shqipe në Ferizaj “Ismail Qemali” po funksionalizohet. Gjatë ditës së djeshme është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi mes MKRS-së dhe komunës së Ferizajt që

ky objekt, që tashmë është pjesë e trashëgimisë kulturore, të jetë në shërbim të Shkollës së Mesme “Çesk Zadeja”, Dega e Arteve Figurative Aplikative. Ministria e Kulturës, po ashtu, ka ndarë 20 mijë euro për sigurimin e inventarit dhe

rekuizitave muzikore dhe artistike në funksion të shkollës.

Në ambientet e rinovuara të shkollës, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor ka hapur një ekspozitë me fotografi të objekteve që janë në mbrojtje të trashëgimisë

kulturore.

Të pranishëm në këtë ngjarje ishin zëvendësministrja Daulina Osmani, u. d. sekretari i përgjithshëm i MKRS-së, Xheladin Krasniqi, kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, këshilltarja e lartë Nora Arapi Krasniqi dhe përfaqësues të



institucioneve të trashëgimisë kulturore.

BE-ja kushtëzon integrimin e Serbisë me normalizimin e raporteve me Kosovën

PRISHTINË, 16 PRILL - Ambasadorët e 27 vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, të grupit të quajtur COREPER, ka arritur marrëveshje për ndryshimin e kornizës negociuese për anëtarësimin e Serbisë, ndryshime të cilat thonë se zbatimi i marrëveshjes në rrugën drejt normalizimit të raporteve me Kosovën bëhet pjesë përbërëse e kapitullit 35 të kësaj kornize.

Në dokumentin e miratuar nga përfaqësuesit e përhershëm të vendeve anëtare në BE në të cilin ka pasur qasje Radio Evropa e Lirë, rikujtohet se Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje në shkurtin e vitit të kaluar në Bruksel dhe më pas në mars në Ohër kanë arritur pajtimin për aneksin e zbatimit të marrëveshjes.

Në dokument u tha se zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të jetë pjesë përbërëse e kushtëzimeve në rrugën e të dyja shteteve drejt integritetit në BE.

Propozimi për ta ndryshuar kapitullin 35 të kornizës negociuese për Serbinë e kishin bërë Komisioni Evropian dhe Shërbimi i Veprimit të Jashtëm të BE-së pasi një gjë e tillë ishte



kërkuar nga shtetet anëtare të BE-së. Pas disa dështimeve që në grupet punuese të BE-së të arrihej marrëveshje për këto ndryshime, çështja kishte kaluar në COREPER, dhe mbrëmjen e 15 prillit, vendet anëtare kishin arritur pajtim.

Pasi të formalizohet ky ndryshim, me shkrim do t'i komunikohet edhe Serbisë, e cila është në procesin e negociatave për anëtarësim në bllokun evropian. Përparimi në procesin e normalizimit të raporteve me Kosovën edhe më herët kishte

qenë pjesë e kushtëzimeve në negociatat e anëtarësimit të Beogradit në BE, por tani në mënyrë specifike përmendet kushti i zbatimit të marrëveshjes të arritur vitin e kaluar.

Kjo marrëveshje, prej 11 nenesh, ndër të tjera, parasheh edhe një

nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, ndërsa kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t'i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut.

Në tekstin e ri të kornizës negociuese si kusht është vendosur kjo fjali: "Serbia zbaton plotësisht obligimet që dalin nga marrëveshja në rrugën drejt normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë, sipas Aneksit të zbatimit të saj, siç ishin pajtuar më 18 mars të vitit 2023".

BE-ja insiston se marrëveshja dhe aneksi, pavarësisht se nuk janë nënshkruar nga palët, janë obligime ligjore për të dyja vendet. Serbia përmes zyrtarëve të saj disa herë ka thënë se nuk do të zbatojë pjesë të marrëveshjes që kanë të bëjnë me integritetin territorial dhe pranimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare.

Pasi Kosova nuk e ka statusin e vendit kandidat për në BE, obligimet e Kosovës për zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të përfshihen në punën e grupit të posaçëm për normalizim.

Grupi BEI bën plan për ta rritur mbështetjen për sektorin e sigurisë dhe të mbrojtjes në Evropë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 16 prill - Grupi i Bankës Evropiane të Investimeve (Grupi i BEI-t) do t'i përditësojë politikën dhe kuadrin e tij për kreditimin lidhur me sektorin e sigurisë dhe të mbrojtjes. Kjo përfshin një përditësim të përkufizimit të mallrave dhe të infrastrukturës me përdorim të dyfishtë, si dhe mbështetje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) dhe sipërmarrjet e vogla dhe angazhim për ta përhshpejtuar shpërndarjen e fondeve me qëllim forcimin e sigurisë dhe të kapaciteteve mbrojtëse të

Evropës.

Plani i veprimit për sektorin e sigurisë dhe të mbrojtjes i Grupit të BEI-t u paraqit kohën e fundit nga presidentja e BEI-t, Nadia Calvino, në takimin e ministrave të Financave të BE-së (ECOFIN) në Luksemburg.

Plani i veprimit vjen pas dy muajve të angazhimit intensiv me palët e interesuara të bankës, palët kryesore të interesit dhe tregjet, dhe vepron sipas mandatit të fundit të Këshillit Evropian për të përmirësuar më tej qasjen në financa për kompanitë evropiane në fushën e mbrojtjes, duke mbrojtur njëkohësisht kapacitetin

financues të Grupit të BEI-t. "Ne do të shtojmë dhe përhshpejtojmë mbështetjen tonë për sektorin e sigurisë dhe të mbrojtjes së Evropës, duke ruajtur kapacitetin tonë financiar dhe standardet më të larta mjedisore, sociale dhe të qeverisjes. Si krahu financiar i BE-së, ne duhet të kontribuojmë në garantimin e paqes dhe të sigurisë së Evropës. Plani i veprimit do t'i përmirësojë kushtet e financimit për projektet evropiane. Ne do të punojmë së bashku me shtetet anëtare dhe institucionet e BE-së për t'i përhshpejtuar projektet që sigurojnë mirëqenien e qytetarëve tanë", tha presidentja Calvino.

Në vazhdim banka do të heqë dorë nga kërkesa që projektet me përdorim të dyfishtë të nxjerrin më shumë se 50% të të ardhurave të tyre të pritshme nga përdorimi civil. Kjo do ta lidhë Grupin e BEI-t me institucionet financiare publike që kufizojnë financimin e tyre në mënyrë të barabartë në pajisje dhe infrastrukturë, të cilat u shërbejnë nevojave mbrojtëse ushtarake ose të ruajtjes së rendit, si dhe nevojave civile, si zbulimi, survejimi, mbrojtja dhe kontrolli i spektrit, dekontaminimi, kërkim-zhvillimi, pajisja, gatishmëria ushtarake, kontrolli kufitar dhe mbrojtja e infrastrukturës tjetër kritike, si dhe dronët.

Për më tepër, Grupi i BEI-t do t'i përditësojë rregullat e veta për financimin e NVM-ve në sektorin e sigurisë dhe të mbrojtjes. Kjo do të krijojë linja të dedikuara kreditimi për një numër të madh kompanish më të vogla dhe sipërmarrje të reja inovative të cilat kërkojnë fonde për projekte me përdorim të dyfishtë.

Grupi i BEI-t planifikon t'i forcojë menjëherë partneritetet dhe bashkëpunimin me palët kryesore të interesuara, duke përfshirë nënshkrimin dhe përditësimin e memorandumeve të mirëkuptimit me Agjencinë Evropiane të Mbrojtjes dhe partnerë të tjerë.

Më e rëndësishmja është se banka planifikon të riorganizojë dhe përmirësojë proceset e saj të brendshme, duke krijuar një grup të posaçëm pune dhe shërbime të njësuara për projektet e sigurisë dhe të mbrojtjes, që do të jenë funksionale deri më 1 maj 2024. Kjo do t'i përhshpejtojë investimet dhe qasjen në fondet e grupit të BEI-t për klientët në sektorin e sigurisë dhe të mbrojtjes së Evropës për të shpërndarë 6 miliardë euro financime të disponueshme në kuadër të Nismës Strategjike Evropiane të Sigurisë (SESI), dhe kështu do ta rrisë më tej mbështetjen tashmë të konsiderueshme të BEI-t për sektorin e sigurisë dhe të mbrojtjes në Evropë sipas kuadrit ekzistues. Propozimet u nënshtrohen proceseve të brendshme të miratimit nga grupi i BEI-t.

Ministri Murati udhëton për në ShBA

PRISHTINË, 16 PRILL - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, do të marrë pjesë në takimet pranverore të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar të cilat mbahen në Uashington. Këto takime mbledhin ministrat e financave, guvernatorët e bankave qendrore, përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare financiare, përfaqësuesit e sektorit privat si dhe të shoqërisë civile të

mbi 100 shteteve në mbarë botën. Një ndër pikat kryesore të këtyre takimeve do të jetë edhe nënshkrimi i marrëveshjes për financimin e politikave zhvillimore për politikën fiskale, konkurrueshmërinë dhe rritjen e gjelbër ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore, që i sjell Kosovës mbi 90 milionë euro me kushte të buta financimi. Gjithashtu, me ftesë të

drejtoreshës menaxhuese për operacione të Bankës Botërore, ministri Murati do të marrë pjesë në tryezën e diskutimeve ministeriale me temë “zbatimin e projekteve për rezultate më të shpejta dhe ndikim më të madh”. Gjatë qëndrimit në Uashington, ministri Murati pritet të takojë edhe përfaqësues nga menaxhmenti i lartë i Bankës Botërore dhe FMN-së, si dhe institucioneve të tjera që marrin pjesë në këtë ngjarje.



Guvernatori i BQK-së zotohet për forcimin e politikës së investimeve në përputhje me praktikën ndërkombëtare



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 16 PRILL - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Ahmet Ismaili, i shoqëruar me bashkëpunëtorët, u mirëprit në selinë e Bankës Botërore nga zëvendës-presidenti, njëherësh drejtuesi i Thesarit i BB-së, Jorge Familiar, për të zhvilluar diskutime të frytshme që lidhen me menaxhimin e rezervës dhe iniciativat e tjera për ngritjen e kapaciteteve të institucionit që ai drejton. Guvernatori Ismaili theksoi vlerësimin e tij të singertë për anëtarësimin e BQK-së në

Partneritetin për Këshillimin dhe Menaxhimin e Rezervave (RAMP) dhe mundësitë e paçmueshme që ka ofruar ky program për ngritjen e ekspertizës dhe kapaciteteve të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës përmes seminareve dhe programeve të saj trajnuese. Po ashtu, Ismaili shprehu mirënjohjen e tij për vizitën e delegacionit të nivelit të lartë të Bankës Botërore, e cila u zhvillua në mars 2024 në Prishtinë, vetëm gjashtë muaj pasi Republika e Kosovës është anëtarësuar në Programin RAMP në muajin tetor 2023. Në takim u theksua se këtë vit

Forumi i Huamarrësve Qeveritarë i organizuar nga Banka Botërore, i cili do të mbahet në Prishtinë, demonstroi bashkëpunimin në rritje ndërmjet BB-së dhe institucioneve të Republikës së Kosovës. Për më tepër, guvernatori Ismaili nënvizoi përkushtimin e palëkundur të BQK-së për forcimin e politikës së saj të investimeve në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare. Ai përsëriti gatishmërinë e BQK-së për ta shfrytëzuar mbështetjen e ofruar nga Programi RAMP për ta arritur këtë objektivi në mënyrë efektive. Andaj, duke u përafuar me

standardet më të mira, BQK-ja synon ta rrisë stabilitetin e saj financiar dhe të kontribuojë pozitivisht në forcimin e institucionit. Gjatë takimit diskutimet u fokusuan edhe në progresin e bërë drejt investimeve të përgjegjshme mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (esg). Guvernatori Ismaili theksoi përkushtimin e BQK-së ndaj këtij qëllimi, i cili është paraqitur dukshëm në Planin Strategjik 2024-2028. Duke integruar parimet e ESG-së në kornizën e saj të investimeve, BQK-ja kërkon ta nxisë zhvillimin e qëndrueshëm dhe t'i respektojë

standardet etike në aktivitetet e saj të menaxhimit të rezervës. Në fund, Ismaili shprehu mirënjohje për delegacionin e RAMP-it të Bankës Botërore, për ekspertizën e tyre të vlefshme dhe përpjekjet bashkëpunuese në avancimin e praktikave të menaxhimit të rezervës dhe iniciativave për ngritjen e kapaciteteve në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Shkëmbimi i frytshëm i ideve dhe ekspertizës gjatë takimit forcon edhe më tej partneritetin ndërmjet BQK-së dhe BB-së, duke hapur rrugën progresit të vazhdueshëm dhe suksesit në arritjen e objektivave të ndërsjella.

Specialja shenjëstron tri raste të reja, të përfshirë 30 persona, konfiskon mijëra euro, vetura dhe telefona

PRISHTINË, 16 PRILL - Nën udhëheqjen e kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale, Blerim Isufaj, është mbajtur takimi i radhës me ekipin e përbashkët për përzgjedhjen dhe shenjëstrimin e krimeve të rënda, ku janë shenjëstruar tri raste të reja me tridhjetë persona të përfshirë në vepra të ndryshme penale. Prokuroria Speciale njofton se në rastin e parë janë përfshirë shtatë persona, prej tyre katër gjenden në paraburgim dhe tre në masën e arrestit shtëpiak për veprën penale “Hyryje në sistemet kompjuterike”, nga neni 327 i

KPRK-së, “Mashtrimi”, nga neni 23 dhe “Shpëlarje e parave”, nga neni 302 i KPRK-së dhe veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366, paragrafi 1 i KPRK-së. Në këtë rast janë konfiskuar 257.540,00 euro, shtatë vetura, nëntë telefona, kompjuterë dhe pajisje kompjuterike, një armë e gjatë dhe një pistoletë. Në rastin e dytë janë përfshirë nëntëmbëdhjetë persona, tre prej tyre gjenden në paraburgim për veprën penale “Import, eksport,

furnizim, transportim, prodhim, këmbim, ndërmjetësim ose shitje të paautorizuar të armëve apo të materieve plasëse”, nga neni 364 dhe 31 të KPRK-së dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së. Në këtë rast janë konfiskuar tridhjetë e pesë armë, katër vetura, 650 euro, dy telefona dhe fishekë të kalibrave të ndryshëm. Ndërkaq, në rastin e tretë të shenjëstruar janë të përfshirë katër persona për veprat penale “Keqpërdorim i



pozitës apo autoritetit zyrtar”, nga neni 414 dhe “Dhënia e ndihmës”, nga neni 33 në

kryerjen e veprës penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

DOKUMENTE BRITANIKE PER DEMONSTRAT E VITIT 1981 NË KOSOVË (19)



Prof. dr. Sabit SYLA &
Prof. dr. Hamit KABA

-128-

Konfidenciale

Z. Montgomery

Z. Broomfield

11 dhjetor 1981

Politika e jashtme e Shqipërisë

1. Keni kërkuar komente mbi vlerësimin e Profesor Vukadinoviçit për politikën e jashtme shqiptare siç raportohet në paragrafët 15-17 të përkujtesës së Z. Barrass. Paragrafi 15

2. Mendoj se ka shumë për të thënë në këtë drejtim. Politika e jashtme e Shqipërisë që në vitin 1948, është bazuar në nevojën për të shmangur dominimin jugosllav. Mjeti më i mirë për të sigurua këtë ka qenë patronazhi i një fuqie të madhe (në mënyrë të njëpasnjëshme BRSS dhe Kina) që ka marrëdhënie të dobëta me Jugosllavinë (meqë ra fjala, jam mjaft i sigurt se dyshimi që shqiptarët mund të mos jenë në gjendje të qëndrojnë pa një patron, mund të jetë frika që theksojnë pohimet e përsëritura, por, mesa di unë, të pabazuara të jugosllavëve për një bosht bullgaro-shqiptar). Por kjo politikë ka përfunduar gjithmonë me faktin e një rëndësie më të madhe strategjike dhe politike të Jugosllavisë. Secili nga patronët e Shqipërisë kanë qenë të detyruar nga ana e tyre që të ndreqin kufijtë e saj me Jugosllavinë dhe kjo gjë në mendjen e shqiptarëve ka krijuar perspektivën se një ditë patronët e tyre mund të jenë të përgatitur për t'i shitur ata me qëllim që të kultivojnë jugosllavët. Ky ka qenë një faktor kyç në përcarjet e njëpasnjëshme shqiptaro-sovjetike dhe shqiptaro-kinaze. Paragrafi 16

3. Por nuk jam i bindur se një gjë e tillë vë theksin domosdoshmërisht në një rivendosje të hershme të marrëdhënieve miqësore shqiptaro-sovjetike. Për momentin, shqiptarët po përqendrohen qartazi në Evropën Perëndimore dhe Botën e Tretë. Në aspektin afatgjatë mbrojtja ruse mund të duket vërtet për shqiptarët e vetmja mburojë kundër Jugosllavisë. Por nuk ka garanci se rusët do t'i përgjigjeshin përcapjeve shqiptare për afrim. Për momentin, ata e shohin Jugosllavinë qartazi si një çmim më i lartë sesa Shqipëria dhe, për pasojë, mendoj se ata nuk do të cenojnë marrëdhëniet e tyre me Jugosllavinë, duke kultivuar

haptazi marrëdhëniet me shqiptarët. Megjithatë, nëse rusët do ta ndjenin se nuk po arrijnë ndonjë gjë me jugosllavët, lidhjet e tyre më të ngushta me Shqipërinë do të përbënin një mënyrë të mirë për t'i bërë presion Jugosllavisë. Gjithashtu, Shqipëria do të ofronte bazën ideale nga e cila do të nxiteshin trazira në Kosovë, Mal të Zi apo Maqedoni.

Paragrafi 17

4. Nuk e kam dëgjuar këtë sugjerim më parë megjithëse, së paku, fjalia e parë është bindëse. Siç thotë Profesor Vukadinoviç, tregtia e Shqipërisë me anëtarët e Kominternit të Evropës Lindore është rritur me shpejtësi që prej prishjes me Kinën. Por, po kjo e vërtetë qëndron edhe për tregtinë e Shqipërisë me Evropën Perëndimore (madje edhe me ne). Unë mendoj se kjo i atribuohet kryesisht nevojës së shqiptarëve për t'u shkëputur nga kinezët, të cilët deri në vitin 1978, përfaqësonin më shumë se gjysmën e tregtisë së përgjithshme të Shqipërisë.

J. C. R. Gray

-129-

Për përdorim të kufizuar

J C R Gray Esq
Ambasada britanike
Beograd
15 dhjetor 1981
EESD
FCO
I nderuar Charles,

Kosova: situata politike dhe e sigurisë

Përmbledhje

1. Ka pasur dy incidente të tjera që kanë bërë bujë në Universitetin e Prishtinës dhe incidente nacionaliste në Mitrovicën e Titos dhe në Pejë. Nacionalizmi shqiptar është shfaqur gjithashtu në Mal të Zi afër kufirit me Shqipërinë. Janë raportuar humbje të panumërta ekonomike të shkaktuara nga pakujdesia dhe papërgjegjshmëria në punë. Në një vizitë në Kosovë, Kryeministri Gjuranoviç e vlerësoi situatën politike dhe të sigurisë si "ende të ndërlikuar".

Detaje

Universiteti i Prishtinës

2. Ka pasur dy 'provokime' të tjera në Universitetin e Prishtinës (shih shkresën time dërguar për ju më 9 nëntor). Në kohën e drekës, më 10 dhjetor, një numër prej 90 vetash, shumica e tyre studentë, vërshuan në një mensë studentësh dhe i detyruan njerëzit që po shërbenin ushqimin që t'i jepnin atyre një drekë falas. Këta elementë turbullues u shpërndanë përpara profesorëve dhe mësuesve për t'i dalluar që kishin mbërritur. Gazeta "Borba" e datës 13 dhjetor tha se ky rast ishte haptazi një incident i mirorganizuar

meqenëse në radhët e tyre ishte edhe një grup punëtorësh ndërtimi nga Vushtrria, të cilët kishin qenë në grevë pak ditë më parë. Rasti në fjalë u vlerësua zyrtarisht se ishte një provokim i frymëzuar nacionalist. Në incidentin e dytë, më 12 dhjetor në orën 23:00, rreth 300 studentë krijuan një trazirë tjetër të ndezur, duke hedhur karrige përreth dhe duke vrapur nëpër rrugë pasi panë në TV heroin lokal të boksit nga Prishtina, i cili kishte mundur kundërshtarin e tij në një ndeshje boksi ndërmjet Jugosllavisë dhe SHBA.

3. Një zëdhënës zyrtar për Qendrën Studentore në Prishtinë konfirmoi se forcat armiqësore ishin ende aktive në Universitet. Çdo ditë shfaqeshin parulla në konvikte, u shpreh ai, ku në disa thuhej "Poshtë Titizmi" dhe "Patriotët shqiptarë nuk shkruajnë në mure - dalin në rrugë". Por, pjesa më e madhe e studentëve që shkaktonin trazira në konvikte dhe përreth tyre, nuk ishin banorë në konvikte; në të vërtetë, kur një banor konvikti kishte pyetur receptionistin e konviktit që të pranonte një person 'të jashtëm' për atë natë dhe kjo kërkesë ishte refuzuar, një grup studentësh e kishin rrahur receptionistin.

Mitrovica e Titos dhe Peja

4. Më 23 nëntor, Komuna e Mitrovicës, qyteti i kompleksit minerar të Trepçës e ndryshoi emrin në Mitrovica e Titos, dhe Drvar në Bosnje-Hercegovinë u bë të nesërmen Drvar i Titos për nder të Presidentit Tito. Këto ndryshime u raportuan se u pritën me gëzim nga banorët e të dyja qyteteve. Megjithatë, disa jugosllavë u shprehën privatisht se ndryshimi i emrit të komunës së Mitrovicës në rrethanat aktuale shkaktoi një provokim të panevojshëm; me të vërtetë, më 26 nëntor, një tabelë e re rrugore që mbante shënimin 'Mitrovica e Titos' u zhduk nga periferitë e qytetit ndërkohë që hajdutët përfituan nga mjegulla e dendur! Ky veprim u denoncua

menjëherë si një akt armiqësor, por autorët nuk u kapën dhe as tabela rrugore nuk u rivendos. Kryetari lokal tha se situata politike dhe e sigurisë në këtë zonë ishte ende "e ndërlikuar", por se kishte pasur përmirësime kohët e fundit në faktin që parullat fyese nuk shfaqeshin më në muret e fabrikave.

5. Më 12 dhjetor, Gazeta "Politika" raportonte se 31 njerëz ishin përjashtuar nga LKJ në Pejë. Ata ishin anëtarë të organizatave të ndryshme punëtore dhe të shkollave në të cilat mbisundonin "dobësitë, oportunitizmi dhe marrëdhëniet e dobëta ndër-komunale". Për më tepër, Organizata e Veteranëve të Pejës, më 11 dhjetor shprehu shqetësimin për sigurinë e banorëve të Pejës nga sulmet e frymëzuara nga nacionalistët; Disa serbë dhe malazezë ishin dëmtuar rëndë gjatë sulmeve dy ditë më parë. Gazeta e sotme "Politika" kishte intervista të shkurtër me 3 nga viktimat e këtyre ngjarjeve dhe komentoi se ky ishte "padyshim një rast i një bande të mirë-organizuar rrugaçësh të prirë për të përhapur trazira në komunitetin serb dhe atë malazez". Nacionalizmi shqiptar në Mal të Zi

6. Nacionalizmi shqiptar është shfaqur në forma të ndryshme edhe në Ulqin në Mal të Zi pranë kufirit jugosllavo-shqiptar. Më 9 dhjetor, situata u vlerësua nga LKJ e Obstinës si "më e rëndë se asnjëherë tjetër gjatë tre dekadave të fundit". Kongresi i Partisë në Shqipëri, veçanërisht kishte nxitur rritjen e aktivitetit nacionalist. Këngët nacionaliste gjëmonin nga altoparantët e vendosur në fshatin Sukobin në kufi; folësve jo-shqiptarë u ishte refuzuar shërbimi në markete dhe ishin bërë kërkesa që faturinot e autobusëve për rrugë të caktuara të ishin shqiptarë. Një seminar i punonjësve të arsimit në shtator ishte kthyer në forum për çështje dhe ankesa nacionaliste. LKJ në Ulqin

shpërndau Organizatën e Partisë në Sukobin, përjashtoi 10 anëtarë Partie dhe rekomandoi shkarkimin nga puna të 9 personave në arsim.

Dëmet ekonomike dhe industriale të Kosovës

7. Më 14 dhjetor, Kryesia e Lidhjes Socialiste të Kosovës vlerësoi me trishtim ekonominë e Kosovës. Rritja ekonomike nuk po materializohej, produktiviteti po binte dhe ndërkohë që pagat vazhdonin të rriteshin, po kështu rriteshin edhe humbjet, të cilat në nëntë muajt e parë të këtij viti arritën në 1.85 miliard dinarë. Gazeta "Politika", më 14 dhjetor raportonte pasojat shkatërrimtare të papërgjegjshmërisë dhe neglizhencës së përhapur në fabrikat e Kosovës (shih shkresën time dërguar për ju më 8 shtator, paragrafi 13). Gjatë dy muajve të fundit, dëmet e shkaktuara vetëm nga zjarret e vëna arrinin në 68 milionë dollarë, por kishte edhe mijëra raste mashtrimi apo kriminaliteti tjetër. "Shkaku kryesor i këtyre rasteve duhet të kërkohet kryesisht në marrëdhëniet e pazhvilluara vetë-menaxhuese, në plogëshinë dhe papërgjegjshmërinë", siç e përmbledhi një mbledhje e kohëve të fundit të Vetë-Mbrojtjes Sociale të Kosovës.

Gjuranoviç viziton Kosovën

8. Më 11 dhe 12 dhjetor, Kryeministri Federal Veselin Djuranoviç vizitoi Kosovën i shoqëruar nga Ivan Stamboliq. Ata ndaluan në fabrika të ndryshme për të diskutuar problemet lokale me punëtorët dhe menaxherët. Raporti i mbledhjes së tyre me udhëheqësit kryesorë të Kosovës thoshte se proceset e përmirësimit dhe konsolidimit ishin tashmë në proces, "por situata politike dhe e sigurisë në Kosovë është ende shumë e ndërlikuar dhe e rrethuar me probleme". Duhej zbatuar politika e Platformës Politike të KQ të LKJ si dhe nevojitej që deri



në fund të vitit të bihej dakord për Planin Social të Kosovës (Komiteti Krahinor i LKK do të mbledhet më 21 dhjetor për të diskutuar zbatimin në praktikë të Platformës).

Komente

9. Siç përmendet në njoftimin e tretë të ambasadorit për Kosovën (paragrafi 12), Platforma Politike e KQ të LKJ e ka hequr përmendjen e përfshirjes së punëtorëve në trazira në Kosovë dhe rreth saj. Sidoqoftë, incidentet e fundit të përshkruara më lart sugjerojnë se trazirat nacionaliste të formave të ndryshme janë gjithsesi të pranishme në fabrika, shkolla dhe vende të tjera pune. Gjithashtu, megjithëse autoritetet qendrore janë duke minimizuar incidentet e fundit në Universitetin e Prishtinës, përsëri është e habitshme se jo pak studentë aty janë ende të patrembur për të rrezikuar dënime të rënda duke i përfshirë në lojëra të rënda nacionaliste.

I Juaji

Charles Crawford

Për dijeni: P Rosling Esq, Zagreb
P Rennie Esq, Departamenti i Kërkimit, FCO

-130-

Konfidenciale

Kërkesë e ambasadorit jugosllav për Z. Bullard,

23 dhjetor 1981

1. Kërkesa e Z. Stamenkoviçit bëhej për të konfirmuar pozitën e Qeverisë së Madhërisë së Saj mbi pretendimet e qarta shqiptare për territorin jugosllav dhe për të bërë të qartë pozitën e Jugosllavisë. Duke iu referuar Notës që i është dorëzuar ambasadorit shqiptar në Beograd më 4 dhjetor (bashkangjitur), Z. Stamenkoviç tha se Jugosllavia dëshironte të mbante marrëdhënie të mira me Shqipërinë, por i duhej që të reagonte ndaj disa veprimeve të papranueshme. Shqiptarët dëshironin që të ndryshonte pozita e Kosovës, duke e shndërruar atë në Republikë brenda Jugosllavisë. Kjo ishte ndërhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë. Hapi tjetër ndoshta do të ishte përpjekja për të përfshirë Kosovën brenda Shqipërisë. Hoxha kishte thënë disa vite më parë se qëllimi i tij ishte që të bashkonte të gjithë shqiptarët në një shtet. Jugosllavia kishte frikë se shqiptarët, të cilët ishin përpjekur të fitonin mbështetje në Perëndim për idetë e tyre, po përpjekeshin të destabilizojnë të gjithë rajonin.

2. Z. Bullard shpjegoi se meqenëse Britania nuk kishte marrëdhënie diplomatike me Shqipërinë, njohuritë tona mbi zhvillimet e atij vendi ishin të limituara. Ne nuk e dinim nëse incidenti i Kosovës ishte provokuar nga shqiptarët, megjithëse padyshim ata e kishin shfrytëzuar atë. Britania e konsideronte integritetin dhe pavarësinë e Jugosllavisë si shumë të rëndësishme dhe do t'i

vinte keq për çdo gjë që mund ta dëmtonte këtë fakt.

3. Megjithëse Z. Stamenkoviç pa një mundësi të Bashkimit Sovjetik që tëkenë ndërhyrë tek shqiptarët, ai tha se nuk kishte tregues që incidenti i Kosovës të jetë provokuar nga shqiptarët në përgjigje të vlerësimit të kërkesës së Spanjës për të hyrë në NATO.

4. Pas disa vërejtjeve të përgjithshme për Poloninë, Z. Stamenkoviç iu kthye çështjes së rrezikut të destabilizimit në rajon dhe veçanërisht në Jugosllavi. Ai theksoi se Jugosllavia po bënte përpjekje reale për të kapërcyer vështirësitë e saj ekonomike. Ajo synonte të zgjeronte tregtinë e saj në Perëndim, ndoshta për shkak se në të kaluarën ishte përqendruar shumë në tregtinë me Lindjen. Njerëzit ishin të gatshëm të bënin sakrificë. Ata kishin pranuar një rënie prej 7% në nivelin e jetesës si në vitin e kaluar, dhe në atë aktual.

Departamenti Sovjetik & i Evropës Lindore
24 dhjetor 1981

Shpërndarë për:

Z. Bullard

Z. Broomfield, EESD

Z. Gray, EESD

Zyra e Kancelarit, Beograd.

-131-

Konfidenciale

FM Beograd ZIGR 5028

Situata e brendshme në Jugosllavi-Kosovë

1. Situata në Kosovë ka ndryshuar që prej përshkrimit në telegramin e përmendur. Herë pas here vazhdojnë të zhvillohen demonstrata sporadike në shkallë të vogël si dhe akte të tjera proteste, por duket se autoritetet tani janë në gjendje të mbajnë situatën nën kontroll pa përdorimin e tepruar të forcës (megjithëse ende jo normale/jo plotësisht normale, situata në Kosovë duket se është normalizuar).

2. Gjyqet në lidhje me demonstratat e pranverës së kaluar, duket se kanë mbaruar. Rasti i fundit që mori vëmendjen tonë ishte ai i shqiptarit etnik në Bosnje akuzuar se ka mbështetur statusin e Republikës për Kosovën. Ky rast sjell numrin e personave të gjykuar në 233. Në të ardhmen mund të ketë gjyqe të tjera në lidhje me protestat e

kohëve të fundit: gjatë javëve të fundit ka pasur dy demonstrata të vogla në Universitetin e Prishtinës, disa shkarravitje të parullave dhe heqje të tabelave të qarkullimit jashtë qytetit të posa riemëruar të Mitrovicës së Titos. Shtypi vazhdon të pasqyrojë ngjarje të tilla në detaje.

3. Komiteti Qendror i LKJ ka miratuar kohët e fundit "Platformën Politike", e cila përmban një analizë të pakursyer të dështimit për të miratuar dhe zbatuar politika, të cilat autorët e raporteve besojnë se do të kishin parandaluar zhvillimin e nacionalizmit radikal në Kosovë. Rekomandimet e raporteve përfshijnë rritjen e mëtejshme të ndihmës ekonomike për Kosovën, masa për të siguruar se ndihma është kanalizuar në ndërmarrjet që krijojnë vende pune, dhe një gamë të gjerë masash të planifikuara për të forcuar lidhjet politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të Kosovës me pjesën tjetër të vendit. Një analizë me e detajuar do të dërgohet dorazi.

4. Polemikata jugosllavo-shqiptare mbi çështjen e Kosovës vazhdojnë, ku asnjëra palë nuk tregon ndonjë gatishmëri për të ulur klimën politike, por marrëdhëniet ekonomike nuk janë cenuar. Më 10 dhjetor media jugosllave publikoi tekstin e një note proteste që i është paraqitur ambasadorit shqiptar këtu (më pas ai e ktheu përsëri) dhe në të njëjtën ditë njoftoi se në Tiranë ishte nënshkruar Protokollin e Tregtisë për vitin 1982. Tregtia midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë parashikohet të arrijë në 130 milionë dollarë amerikanë në vitin 1982.

5. Në lidhje me përgjigjen ndaj shkresës së Crosbie (telegrami juaj i përmendur) besojmë se do të ishte me vend të jepet një përgjigje minimale, pasi kjo është çështje me ndjeshmëri tejet ekstreme këtu. Jugosllavët kanë reaguar me shumë ashpërsi ndaj prezantimit të "përfitimit për viktimat e Kosovës", dhe çdo koment tjetër, nëse bëhet publik, mund të nxjerrë përgjigje të tillë të ngjashme. Do t'ju ishim shumë mirënjohës nëse do të kishit mundësinë të komentoni mbi hartimin e ndonjë përgjigjeje të mirëfilltë.

CCC/088 280800ZZLGR5028

-132-

Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit

Londër SW1A 2 AH

24 dhjetor

Shkëlqesisë së Tij

Z. Edwin Bolland KCMG

Beograd

Inderuar Edwin,

Çështja e Kosovës

1. Ju falënderoj për telegramin tuaj të datës 7 dhjetor mbi vazhdimin e tensionit në Kosovë. E kemi dërguar për qarkullim në departamentet përkatëse dhe do ta paraqesim dhe qarkullojmë për komente nga departamentet e interesuara. Nëse del ndonjë gjë me rëndësi të veçantë, do t'ju shkruaj përsëri.

2. Siç keni bërë të qartë, Kosova e paraqet Federatën jugosllave me një problem thelbësor për të cilin nuk mund të ketë zgjidhje të lehtë. Siç e dimë shumë mirë në Mbretërinë e Bashkuar, çështjet e minoriteteve nuk zhduken dhe zhvendosja e përgjithshme etnografike brenda krahinës për të cilën keni tërhequr vëmendjen në paragrafin 14, ka të ngjarë që më shumë t'i acarojë sesa t'i lehtësojë vështirësitë.

3. Sidoqoftë, ka tre aspekte të reagimit të autoriteteve jugosllave të cilat unë i shoh inkurajuese. Në radhë të parë, më duket se ato janë përballur me natyrën e problemit në mënyrë më të drejtpërdrejtë sesa ç'mund të ndodhte në shumë vende të tjera megjithëse mund të kenë bërë përpjekje që disa vështirësi t'i veshin me shkëlqimin e tyre ideologjik. Nuk ka përpjekje për t'i shpëtuar problemit duke e paraqitura të si thjesht një pasqyrim i përkohshëm i qeverisjes së keqe ose i disavantazheve sociale dhe ekonomike. Ka një pranim të qartë se thelbi i problemit qëndron në nacionalizmin e Kosovës (paragrafi 6). 4. Së dyti, jugosllavët duket se kanë reaguar ndaj një goditjeje të papritur me forcë dhe realizëm. 'Platforma' përfaqëson një përpjekje pozitive praktike për trajtimin e problemit dhe megjithëse ne nuk i pëlqejmë disa nga aspektet ideologjike, kjo platformë është brenda kuadrit të sistemit jugosllav si përpjekje konstruktive për të vënë situatën nën kontroll. 5. Së treti, ka një pikë më të gjerë

ndaj së cilës ju keni tërhequr vëmendjen në paragrafin tuaj 17 sipas të cilit sinqeriteti i debatit si në shtyp dhe në Komitetin Qendror pasqyron një hap të rëndësishëm përpara drejt demokratizimit.

6. Ne do të vëzhgojmë me interes hapat e mëtejshëm për t'u angazhuar në këtë problem me sigurinë se të paktën jugosllavët duket se do të vazhdojnë me një diagnozë të shëndetshme edhe nëse trajtimi mund të dalë më i vështirë nga sa ata e kanë parashikuar.

I Juaji,

N H R A Broomfield

Departamenti Sovjetik & i Evropës Lindore

-133-

Për përdorim të kufizuar

RR Beograd

RR Romë

RR Ankara

RR Athinë

GRS 60

FM FCO 211645Z dhjetor '81

Informacion rutinë për Beograd
Telegram nr. 181, i datës 21 dhjetor

Dhe informacion rutinë për Athinë, Romë, Vjenë, Paris, Ankara, dhe të ruhet për Uashington, Moskë, UKDEL NATO

Vdekja e kryeministrit

1. Në mungesë të misionit tonë në Tiranë, do të ishim mirënjohës për çdo detaj që mund të arrini të nxirrni për rrethanat e vetëvrasjes së pretenduar të Shehut.

Carrington

Kopje për:

Znj. Lewis, Stafi i Vlerësimit

Zyra e Kabinetit

-134-

Për përdorim të kufizuar

GR 100

FM Athinë 221540Z dhjetor '81

Direkt për FCO telegram nr 450 i datës 22 dhjetor '81

Telegrami juaj nr. 181: vdekja e kryeministrit

1. Mazarakis, Kru i Drejtorisë së MPJ, i përshkruan rrethanat e vdekjes së Shehut si "shumë të çuditshme". Sipas Ambasadës greke në Tiranë, ai u varros me nxitim. Qeveria shqiptare i ka thënë grekëve se në vdekjen e tij nuk do të ketë ndonjë ceremoni zyrtare dhe se nuk do të ketë mesazhe ngushëllimi. Ambasada greke ka raportuar gjithashtu zëra të papërmbytura se Hoxha është plagosur, por nuk ka prova për ta mbështetur këtë.

Southerland

Kopje për

Znj. Lewis

Stafi i Vlerësimit

Zyra e Kabinetit

-135-

Për përdorim të kufizuar

GR 80

FM Paris 221446Z dhjetor '81

Direkt për FCO

Telegram nr. 1139, i datës 22 dhjetor 1981

Informacion për Beograd, Athinë, Romë, Vjenë, Ankara,



Uashington, Moskë dhe UKDEL NATO
Telegrami juaj nr. 181 për Beogradin: vdekja e kryeministrit

1. Departamenti i Evropës Lindore i QUAI shprehet se nuk ka informacion që mund të kundërshtojë versionin zyrtar sipas të cilit Shehu ka kryer vetëvrasje në gjendje depresioni nervor. Departamenti nuk është në dijeni të ndonjë informacioni që sugjeron se ai kishte probleme politike, dhe as nuk beson se ai ishte në një gjendje shëndetësore veçanërisht të keqe fizike, megjithëse, njësoj si disa nga kolegët e tij, Shehu kishte shkuar herë pas here për trajtim mjekësor në Francë.

Hibbert
Kopje për
Znj. Lewis
Stafi i Vlerësimit
Zyra e Kabinetit

-136-

Për përdorim të kufizuar

GRS 270
Nga Beogradi 221507Z dhjetor '81
Prioritet për FCO
Telegram nr 229, i datës 22 dhjetor 1981
Informacion për Athinë, Romë, Paris, Vjenë, Ankara.
Informacioni të ruhet për Uashington, Moskë dhe UKDEL NATO

Telegrami juaj nr. 181: vdekja e kryeministrit

1. Obradović, Zëvendës/Sekretari përgjegjës në SFPJ, në një bisedë me mua dhe Ambasadorët e tjerë më 19 dhjetor hedhin dyshime mbi vetëvrasjen e raportuar të Shehut. Ai sugjeroi se Shehu mund të jetë "hequr qafe" për shkak të dallimeve me Hoxhën, ndoshta mbi marrëdhëniet me Jugosllavinë. Ai nuk dha prova për të mbështetur këtë.
2. Shtypi i sotëm ka një raport të "Tanjug-ut", nën titullin "Dyshime për vetëvrasje", ku pasqyrohen dyshimet e shtypit perëndimor (AFP dhe gazeta franceze "Çlirimi") për vërtetësinë e vetëvrasjes së Shehut. "Tanjug" raporton se Radio Tirana nuk dha asnjë lajm për vetëvrasjen e Shehut deri plot 12 orë pas 'Vetëvrasjes'; gjithashtu, raporton se nuk u dha asnjë detaj mbi atë që ndodhi, nuk pati asnjë ndërprerje të programit normal në Radio dhe se, sipas burimeve Perëndimore, në Tiranë nuk u mbajt asnjë ceremoni, nuk u ngrit flamuri gjysmë shtizë dhe as nuk u hapën librat e ngushëllimit. E gjithë kjo situatë do të dukej e zakonshme pas vdekjes së një personaliteti të lartë shtetëror.
3. "Tanjug" raporton më tej se Shehu u shfaq për herë të fundit në publik më 16 dhjetor kur priti një delegacion nga Rumania për çështje ekonomike. Megjithëse i pranishëm në Kongresin e 8-të të Partisë në fillim të nëntorit, u vu re se ai nuk e ndoqi festimin e Ditës Kombëtare më 28 nëntor.
4. Korrespondenti lokal i Reuters ka dëgjuar nga Ambasadori shqiptar se Ramiz Alia do të jetë



numri 2 në Byronë Politike dhe Adil Çarçani do të bëhet Kryeministër.

FCO, Ju lutem telegrami të dërgohet në adresat e mësipërme.

Bolland
[Të përsëritet sipas kërkesës]

Kopje për:
Znj. Lewis
Stafi i Vlerësimit, Zyra e Kabinetit

-137-

Konfidenciale

Telegram Romë nr. 322
GR 320
Nga: R Culshaw
Dosja REF: 020/18
23 dhjetor 1981
Për ndjekje: J C R Gray Esq., EESD
D. I. Miller Esq., Beograd

Vdekja e kryeministrit të Shqipërisë

1. Telegram i FCO 181 për Beogradin.
2. Vinci Giacchi, Kreu i Departamentit Politik të Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ), më tha dje se italianët nuk kanë informacion të saktë mbi vdekjen e Shehut. Ambasadori i tyre, Gentile, ka vetëm tre muaj që qëndron në Tiranë dhe ende nuk ka kontakte mjaft të mira për të mësuar thelbin e ngjarjes.
3. Vinci Giacchi tha se gjithsesi MPJ nuk (nuk) ishte e prirë që të besonte versionin zyrtar të vdekjes së Shehut si vetëvrasje. Në Kongresin e Partisë në Nëntor ai nuk kishte dhënë shenja sëmundjeje të rëndë apo të depresionit nervor. Ai mund të ketë pritur të ketë shumë vite të tjera në jetën aktive politike. Për më tepër, qëndrimi i qeverisë shqiptare pas vdekjes së tij dukej shumë i çuditshëm: Shehut nuk i ishin bërë të gjitha nderimet e duhura që i takonin si Kryeministër.
4. Hamendësimi më i fortë i Vinci Giacchit ishte se midis Hoxhës dhe Shehut ishte krijuar diferencimi politik mbi marrëdhëniet me Jugosllavinë ose mbi shkallën e hapjes ndaj Perëndimit që duhej të mbante Shqipëria; ai gjithashtu hamendësonte se Hoxha kishte vendosur ta zëvendësonte atë me dikë tjetër më të bindur. Një tjetër motiv i mundshëm ishte xhelozia për Shehun i cili po fitonte popullaritet. Vinci Giacchi tha se Italia nuk priste ndonjë ndryshim të rëndësishëm në politikat e

Shqipërisë pas vdekjes së Shehut. Vendin e tij do ta zinte ndoshta zëvendësi i tij.

5. Në përfundim, Vinci Giacchi tha se në Tiranë ishte arritur një marrëveshje në parim nga mesi i dhjetorit për të filluar shërbimin me traget nga Bari në Durrës. Motivi i Shqipërisë ishte ndoshta që të ri-siguronte veten ndaj ndonjë ndërhyrjeje në rrugët e saj të furnizimit përmes Jugosllavisë: E vetmja alternativë tjetër praktike ishte rruga për në Athinë, por një gjë e tillë kërkonte shumë punë që të arrinte të ndërmerre rrugë të rregullta me kamionë.

6. Për EESD: Ju lutem dërgoni kopje të këtij telegrami me faksimile për marrësit e tjerë të telegramit të FCO nr. 181, sipas rastit.

Nënshkruar nga: R Culshaw

-138-

Konfidenciale

GRS 200
FM Beograd 231450Z dhjetor '81
Prioritet për FCO
Telegram nr. 232, i datës 23 dhjetor 1981
Informacion rutinë për Athinë, Romë, Paris, Vjenë dhe Ankara, të përsëritet për Uashington, Moskë, UKDEL NATO.

Telegrami im nr. 229: vdekja e kryeministrit

1. Ambasadori amerikan më dha sot informacionin shtesë në vijim duke sugjeruar gjithashtu se vdekja e Shehut nuk ishte vetëvrasje por rezultat i një mosmarrëveshjeje të panjohur politikash me Hoxhën.

2. Melovski, Zëvendës/Sekretar në MPJ, duke folur personalisht, tha se dyshonte që Shehu të ketë kryer vetëvrasje pas një krize nervore, por arsyetoi se mbase ai ka kundërshtuar izolacionizmin fanatik të Hoxhës dhe në vend të kësaj, ka debatuar për marrëdhënie më normale me botën e jashtme. Melovski, duke u kujtuar se i kishte takuar Shehun dhe Hoxhën tridhjetë vjet më parë, e krahasoi të parin si një person racional që ishte i mësuar të merrej me botën reale, ndërsa të dytin si një person që ishte i paparashikueshëm dhe që "jetonte në ndonjë planet tjetër".
3. Anderson tha se Grlickov, anëtar i Kryesisë së Partisë, i kishte thënë atij më 22 dhjetor se edhe ai nuk besonte që Shehu të

ketë kryer vetëvrasje por spekuloi duke thënë se Shehu nuk ishte pajtuar me Hoxhën për një numër ligjesh të rëndësishme që po diskutoheshin aktualisht në Parlamentin shqiptar.

4. Ambasadori shqiptar i kishte thënë Ambasadorit austriak se Tirana nuk dëshironte që Kreisky të dërgonte ndonjë mesazh ngushëllimi për vdekjen e Shehut.

5. FCO, Ju lutem telegram të dërgohet në të gjitha adresat e ruajtura.

[Të përsëritet sipas kërkesës]

Kopje për
Znj. Lewis
Stafi i Vlerësimit
Zyra e Kabinetit

-139-

Konfidenciale

GRS 75
FM Vjenë 231625Z dhjetor '81
Direkt për FCO
Telegram nr. 270, i datës 23 dhjetor
Informacion rutinë për Beograd, Romë
Informacioni të ruhet për Athinë, Paris, Ankara, Uashington, Moskë dhe UKDEL NATO

Telegrami juaj nr. 181 për Beogradin: vdekja e kryeministrit të Shqipërisë

1. Departamenti Lindor i MPJ nuk ka informacion që të kundërshtojë linjën zyrtare shqiptare sipas së cilës Shehu ka kryer vetëvrasje në gjendje depresioni.
2. Ambasada amerikane këtu ka dëgjuar raporte nga Roma ku sugjerohet se vetëvrasja e Shehut është organizuar me qëllim që "të hiqej qafe".

FCO, Ju lutem telegrami të dërgohet në adresat e mësipërme.

Lush
[Të përsëritet sipas kërkesës]
Kopje për
Znj. Lewis
Stafi i Vlerësimit
Zyra e Kabinetit

-140-

ENA 014/1
Ambasada britanike
Moskë
Ref jonë: A 021/8
24 dhjetor 1981
D G Manning Esq
EESD
FCO

Inderuar David,
Vdekja e kryeministrit të Shqipërisë

Gazeta "Pravda" e datës 20 dhjetor ka cituar fjalë për fjalë raportin e dhënë nga Agjencia e Shtypit shqiptar mbi vdekjen e Shehut. Nuk kishte komente.

E Juaja
Anne Jackson
Për dijeni:
Departamenti i Kërkimit, FCO;
Zyra e Kancelarit, Beograd

-141-

Konfidenciale

GRS 290/6
FM Ankara 281235Z dhjetor '81
Përparësi për FCO
Telegrami nr. 257, i datës 28 dhjetor
Informacion rutinë për Beograd, Athinë, Romë, Paris dhe Vjenë.
Informacioni i ruajtur për Uashington, Moskë, UKDEL NATO.

Telegrami juaj Nr. 181 për zyrën e Beogradit: vdekja e kryeministrit të Shqipërisë

1. Kreu i Zyrës së Kancelarit diskutoi çështjen e Shqipërisë me oficerin e informacionit në MPJ turke më 28 dhjetor. Duke theksuar faktin se në mënyrë të pashmangshme ai po tregojë disi spekulativ, Turker tha se turqit nuk e besonin që Shehu të kishte vrarë vërtetë veten. Sipas informacioneve të tyre, ai ishte në gjendje të mirë shëndetësore si nga pikëpamja mendore dhe fizike. Ata mendonin se Shehu ishte detyruar të vraste veten, ose ishte vrarë, pasi kishte humbur luftën për pushtet me ata që aspironin të pasonin Hoxhën.
2. Turqit mendonin se në themel kjo luftë është zhvilluar midis një grupi (të udhëhequr nga Shehu) që favorizonte politikën izolacioniste, dhe grupit të atyre që do të dëshironin të shihnin një politikë më "shumëpalëshe" pas epokës së Hoxhës. Grupi i fundit, i udhëhequr nga Ramiz Alia (paragrafi 4 i telegramit nr. 229 të Beogradit), duket se është në pozitë më të fortë sot, të paktën përkohësisht. Që prej vdekjes së Shehut, e veja e tij, me sa duket, është arrestuar dhe është nxjerrë para gjyqit, por Turker nuk e dinte me çfarë akuze.
3. I pyetur se çfarë roli mund të ketë pasur Hoxha në vdekjen e Shehut, Turker tha se besonte që Hoxha kishte ende kontroll të fortë dhe kështu pothuaj, pa dyshim, duhet të ketë dhënë miratimin e tij paraprak për eliminimin e Shehut, megjithëse mund të mos ketë qenë iniciatori i idesë.
4. Ambasadorit turk në Tiranë i është lënë të kuptojë në mënyrë diskrete, por të qartë nga autoritetet shqiptare se nuk (nuk) ishte e nevojshme për mesazhe ngushëllimi apo formalitete të tjera.
Ju lutem të ruhet kopje për Washington, Moskë, UKDEL NATO.
Laurence
[Të përsëritet sipas kërkesës]
Kopje për
Znj. Lewis
Stafi i Vlerësimit
Zyra e Kabinetit



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Llapi 'kërcënon' FFK-në: Nëse delegohet Visar Kastrati nuk do të dalim në fushë

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 16 PRILL - Skuadra e Llapit ka hedhur akuza në drejtim të gjyqtarit Visar Kastrati. Klubi llapjan pretendon se gjyqtari në fjalë i ka dëmtuar, sidomos në dy ndeshjet e fundit. Skuadra e Llapit akuza pati edhe për gjyqtarin Burim Jahmurataj dhe asistentin e tij Fatlum Jashari. "Duam të reagojmë sërish për mediat, opinionin e futbollit dhe komunitetin e futbollit kosovar, pas analizave në detaje të të gjitha ndeshjeve, sidomos dy ndeshjeve të fundit të gjykuara nga Visar Kastrati. Ky turp i krijuar ndaj nesh ka emër Visar Kastrati, së bashku me ata që e deleguan në ndeshjet e klubit tonë. Rastin e penaltisë së paakorduar ndaj nesh e kemi analizuar dhe konsultuar me shumë njohës të futbollit dhe ndihemi të dëmtuar nga i njëjti




gjyqtar që FFK e shpalli më të mirin, kurse në VAR duke 'fjetur' ishte gjyqtari Burim Jahmurataj dhe asistenti i tij Fatlum Jashari. Ne nuk dyshojmë në aftësitë e tij të gjyqtarit, por gjykimi i tij ishte skandaloz dhe më i keq për futbollin kosovar. Visar Kastrati, i cili punon si Koordinator i referimit dhe merr pagë mujore nga FFK, vazhdon me avazin e vjetër duke dëmtuar një klub të organizuar shkëlqyeshëm si klubi ynë. Kjo

nuk do shumë koment por që po ndikon drejtpërdrejt dhe qëllimisht tek rezultatet tona", thuhet në reagimin e Llapit. Skuadra e Llapit ka kërcënuar edhe Federatën e Futbollit të Kosovës se nëse Visar Kastrati delegohet në ndeshjen në xhiron e radhës, atëherë nuk do të dalë në fushë. "E paralajmërojmë FFK-në se nuk na intereson se si do delegohen gjyqtarët në xhiron e radhës, por në momentin që Visar Kastrati delegohet në ndeshjet tona të ardhshme në këtë kampionat, ne nuk do të dalim në fushë fare, pastaj përgjegjësinë për mosdaljen tonë në fushë le ta mbaj FFK, Komisioni i Garave dhe njerëzit që janë kompetent për delegimin e gjyqtarëve", ka përfunduar reagimi i skuadrës së Llapit. Aktualisht Llapi është në pozitën e tretë me katër pikë më pak se skuadra e Ballkanit që është në vendin e parë në tabelë të Superligës.

Policia e Kosovës kërkon bashkëpunim për arrestimin e xhudistit Akil Gjakova

PEJË, 16 PRILL - Policia e Kosovës ka kërkuar edhe zyrtarisht bashkëpunim për gjetjen dhe arrestimin e xhudistit Akil Gjakova i cili është i ngarkuar me veprën "dhunë në familje". "Policia e Kosovës - Drejtoria Rajonale e Policisë në Pejë, bazuar në ligj për publikimin e fotos me shënime tjera të personit të kërkuar më autorizimin e Prokurorisë themelore në Pejë, me qëllim lokalizimin dhe rrjedhimisht arrestimin e tij, lëshon: Kërkesë për bashkëpunim me qytetarët. Personi i kërkuar është: Akil (Luan) Gjakova i lindur me 04.01.1996 në Pejë. I pandehuri është i kërkuar për veprën penale: - 'Dhunë në familje'. Policia e Kosovës kërkon nga qytetarët e Republikës së Kosovës që kushdo që ka informacion për vendndodhjen e personit të dyshuar në foton e bashkangjitur, të lajmërojë Policinë e Kosovës apo të lajmërohet në stacionin më të afërt policor. Numrat e telefonit dhe adresat elektronike kontaktuese për të kontaktuar Policinë e Kosovës: - 192 dhe 080019999 (pa pagesë) - 039 432 327-Drejtoria Rajonale Pejë. E-mail adresa: info@kosovopolice.com", thuhet në njoftimin e policisë.



SHKURT

Llapi: Ata që janë dorëzuar nuk kanë besuar kurrë

Podujevë, 16 prill - Skuadra e Llapit ka bërë dy gabime të mëdha në garën për titull të kampionit në Superligë. Tash kjo skuadër është plot katër pikë pas Ballkanit, por kjo nuk ka ndikuar aspak që të humbet optimizmi në kampin e llapjanëve të cilët ende janë të motivuar për t'i arritur objektivat. "Ata që janë dorëzuar nuk kanë besuar kurrë. Pavarësisht prej rrethanave dhe pengesave gjatë rrugës, do të vazhdojmë më të fuqishëm dhe më të motivuar se kurrë për arritjen e objektivit. Përpara djema", thuhet në postimin e skuadrës së Llapit.

Finalja e Kupës së Shqipërisë luhet më 14 maj në 'Air Albania'

Federata Shqiptare e Futbollit e ka përcaktuar datën, orën dhe stadiumin ku do të luhet finalja e madhe e Kupës së Shqipërisë për edicionin 2023/2024. Takimi final do të zhvillohet më 14 maj në orën 19:00 në stadiumin "Air Albania". Kupa e Shqipërisë ndodhet në fazën gjysmëfinale dhe deri më tani janë luajtur vetëm takimet e para. Kukësi është një hap larg finale së Kupës së Shqipërisë pasi ka fituar në ndeshjen e parë ndaj Tiranës 2-0, ndërsa Egnatia ka hedhur një hap të rëndësishëm për në finale pasi triumfoi në sfidën e parë ndaj Vllaznisë minimalisht 1-0. Megjithatë, gjithçka do të vendoset në takimet e dyta gjysmëfinale që do të luhet më 24 prill. Tirana - Kukësi do të zhvillohet në orën 15:00, ndërsa Vllaznia - Egnatia në orën 18:00.

Notarja Hana Beiqi shkëlqen në garën e Mariborit

Notarja nga Kosova, Hana Beiqi, shpresë olimpikë 2024, ka shënuar rezultate mbresëlënëse në garën ndërkombëtare "MM Maribor 2024" të mbajtur në Maribor të Sllovenisë. 15-vjeçarja në disiplinën olimpikë 50 metra shënoi kohën 27:21 sekonda, duke çuar në 658 numrin e pikëve të Federatës Ndërkombëtare të Sporteve të Ujit, njofton Komiteti Olimpik i Kosovës. Ndërsa në disiplinën joolimpikë 50m shpinë u bë notarja e parë ndonjëherë nga Kosova që kalon numrin e 700 pikëve. Koha e saj ishte 30:16 sekonda. Sa iu përket medaljeve, ajo në këtë garë fitoi medaljen e artë në 50m krol (kategoria kadetë), argjendte, 50m krol (kategoria absolute), artë në 50m shpinë (absolute), artë në 50m shpinë (kade) dhe argjendte në 100m delfin (kade).

Sadiku fiton titullin e kampionit në Indi

Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Armando Sadiku, e ka festuar titullin kampion për herë të dytë në karrierën e tij. Futbollisti nga Elbasani është shpallur kampion me ekipin e Mohun Bagan në Indi falë një triumfi në javën e fundit ndaj skuadrës së Mumbait që kishte kryesuar kampionatin deri më sot. Mohun Bagan, me Sadikun titullar, triumfoi në ndeshjen e luajtur në Kalkuta me rezultatin e ngushtë 2 me 1, në duelin ndaj ekipit që kishte 2 pikë avantazh në renditje dhe e kaloi në sfidën e fundit, për t'i "rrembyer" titullin kampion në sezonin e rregullt. Sadiku titullin e kishte fituar më herë në kampionatin polak të futbollit, Ekstraklasa, me skuadrën e Legia Warzaw, në sezonin 2017-2018 e trofe të tjerë ka siguruar dy herë Kupën e Zvicrës, një herë Kupën e Polonisë dhe një herë Kupën e Lihtenshtejnit.

Te Red Bullin presin fitoren në Kinë: Ferrari do të jetë rivali ynë

Shanghai, 16 prill - Për herë të parë pas katër sezonesh, që kur pandemia detyroi anulimin e garës së Çmimit të Madh të Kinës, Formula 1 do të rikthehet në Shanghai. Një pistë e panjohur për shumë pilotë të rinj që kanë debutuar vitet e fundit, por edhe për më

të vjetrit do të ketë të panjohura, pasi makinat e sotme nuk kanë garuar kurrë. Gjithsesi, Red Bulli pret të dominojë në këtë pistë dhe i bindur për këtë gjë është shefi i kësaj skuadre, Christian Horner. "Shanghai është një pistë e mirë. Kthesa e parë nuk

mbaron kurrë dhe kthesat me shpejtësi të lartë kanë qenë gjithmonë sfiduese veçanërisht për gomën e majtë të përparme. Ka edhe një garë sprint, e para e këtij viti, ndaj do të jetë një tjetër sfidë për të gjithë", ka thënë Honer. "Ka shumë pika ku mund të

parakalohet, por edhe të panjohura që do të shohim të premtën në provat e lira. Ndaj do të jetë një fundjavë interesante dhe të shohim se si do të shkojë. Ferrari ishte padyshim konkurrues në Australi, por dhe në Japoni pamë se ritmi i tij i garës ishte



konkurrues. Ne presim që ndoshta do të jetë konkurrenti ynë më i afërt edhe në Kinë", ka shtuar Horner.

Manaj tregon 'sekretin' e formës së mirë: Më pëlqen të konsumoj shumë bakllava

SIVAS, 16 MAJ - Rey Manaj po kalon një moment fantastik në Turqi, ku është një nga golashënuesit më të mirë të kampionatit. Duke folur për mediet turke sulmuesi ka treguar edhe "sekretin" e formës së mirë. "Presidenti i Sivasporit ishte i pari që më telefonoi kur unë isha ende i dëmtuar. E kisha ndjekur një vit më parë këtë ekip teksa luante përballë Fiorentinës. Më pas mora disa telefonata edhe nga disa klube të tjera turke, por dëshiroja të luaja me Sivasporin, pasi i kisha dhënë fjalën presidentit. Tani mendoj se e kam bërë mirë zgjedhjen time", ka thënë Manaj. "Tani ndihem mirë, sepse i jam dedikuar këtij sporti. E shikoj me shumë pasion. Vij në stërvitje tri-katër orë përpara dhe kujdesem shumë edhe me ushqimin. Më



pëlqen që të konsumoj shumë bakllava, por e ftoj veten pasi duhet të vrapoj shumë. Preferoj ta konsumoj pas ndeshjeve. Dëshira ime është ta dërgoj Sivasporin mes pesë skuadrave më të mira në Turqi", ka shtuar Manaj, i cili u grumbullua nga

Sylvinho për dy miqësoret që Shqipëria zhvilloi muajin e kaluar. Sulmuesi pritet që të jetë gjithashtu në listën e lojtarëve për dy miqësoret e radhës para Evropianit, teksa deri tani ka shënuar 20 gola mes kampionatit dhe Kupës.

Konfirmohen 11 emrat e yjeve të NBA-s që do të luajnë për ShBA-në në Lojërat Olimpikë

UASHINGTON, 16 PRILL - Dihet 11 nga 12 lojtarët që do të luajnë për përfaqësuesen e basketbollit të Shteteve të Bashkuara në Lojërat Olimpikë të Parisit këtë verë. Gjatë Lojërave Olimpikë në Paris, që luhen nga 27 korriku deri më 10 gusht, në dispozicion të trajnerit Steve Kerr janë vënë yjet më të mëdhenj të ditës së sotme dhe praktikisht është e pamundur që dikush t'i kërcënojë me medaljen e arit. LeBron James, Stephen Curry, Kevin Durant, Joel Embiid, Jayson Tatum, Devin Booker, Jrue Holiday, Anthony Davis, Anthony Edwards, Bam Adebayo dhe Tyrese Haliburton do të luajnë në Paris, dhe emri i lojtari i fundit do të njihet menjëherë përpara vetë turneut. Disa nga lojtarët që konkurrojnë për vendin e fundit janë Kawhi Leonard, Paul George, James Harden, Kyrie Irving, Damian Lillard, Chris Paul, Jaylen Brown dhe Brandon Ingram.



Kujtojmë se përzgjedhja e ShBA-së është në Lojërat Olimpikë në Grupin C me Serbinë, Sudanin e Jugut dhe fituesin e turneut kualifikues në Porto Riko (Lituani, Itali, Porto Riko, Meksikë, Bregun e Fildishtë apo Bahrein). Skuadra e basketbollit të ShBA-së ka më së shumti trofe kur bëhet fjalë për Lojërat Olimpikë me 16 medalje të

arta. Që nga viti 1992, kur lojtarët e NBA-së u lejuan për herë të parë të luanin në Lojëra Olimpikë, ShBA-ja ka fituar shtatë nga tetë ngjarje të mundshme. E vetmja herë kur amerikanët mbetën pa medaljen e arit ndodhi në vitin 2004, kur basketbollistëve të ShBA-së iu desh të kënaqeshin me bronzin.

SHKURT

Nadali rikthehet të luajë në Barcelonë, Alcarazi ngre 'flamurin e bardhë'

Një tenist spanjoll rikthehet të luajë, një tjetër tërhiqet. Rafael Nadal, ish-numri 1 në botë, ka konfirmuar se do të luajë në turneun e Barcelonës që nis sot. Kjo është ndeshja e parë e Nadalit që nga janari, ku luajti në Brisbane para se të tërhiqej. "Jam stërvitur mirë këtë javë dhe mendoj se jam gati për të luajtur. Nuk kam pritshmëri të larta, por dua ta shoh veten time në këtë sipërfaqe. Shpresoj që gjërat të shkojnë mirë dhe të luaj sa më shumë, pa sforcuar veten", ka thënë Nadali. Ndërkohë, ai që ka ngritur "flamurin e bardhë" është talenti spanjoll Carlos Alcaraz. Ai është ende i lënduar në shpatullën e djathtë, ku ndien dhimbje. Ndaj, 20-vjeçari vendosi të mos paraqitet në turneun e Barcelonës. Jo vetëm kaq, por Alcaraz rrezikon të mos luajë as në turneun Masters të Madridit pas 10 ditësh.

Drejtori i Leverkusenit: Alonso mund ta drejtojë Realin në të ardhmen

Drejtori ekzekutiv i Bayer Leverkusenit, Fernando Carro, ka pranuar se Xabi Alonso mund ta drejtojë Real Madridin në të ardhmen. Alonso ka krijuar një reputacion si një nga menaxherët e rinj më të ndritur në Evropë që nga nëntori i 2022-s. Spanjollit e çoi Leverkusenin nga zona e rënies në vendin e gjashtë, ndërsa udhëhoqi skuadrën në gjysmëfinalet e Evropa Ligës. Pasi hodhi themelet sezonin e kaluar, Alonso ka vazhduar të mbikëqyrë një sezon historik 2023-24, duke e çuar klubin drejt titullit të parë të Bundesligës me pesë ndeshje të mbetura. Alonso mund të marrë edhe më shumë çmime të argjendta këtë sezon, me Leverkusenin në finalen e DFB-Pokal dhe çerekfinalet e Evropa Ligës, shkruan "Sportsmole.co".

Pochettino: Penalltia? Sjellje e papranueshme, nuk e tolerojmë më

Chelsea fitoi 6-0 përballë Evertonit ku londinezët dominuan, por që solli një episod të pakëndshëm. Në pjesën e dytë, kur sfida ishte 4-0, Chelsea fitoi një penallti dhe Madueke, Jackson e Palmer "diskutuan" fortë me njëri-tjetrin se kush do ta merrte përsipër ekzekutimin. Në fund Palmeri shënoi, teksa kjo gjë nuk i ka pëlqyer aspak Pochettino. "U thashë lojtarëve që nuk mund të sillemi në këtë mënyrë. Kjo është hera e fundit që do ta pranoj këtë lloj sjelljeje. Ata janë të gjithë të përfshirë në këtë situatë. Herën tjetër do të dalin të gjithë dhe po flas seriozisht", ka thënë Pochettino.

Djali i Ancelottit nuk i fsheh ambiciet: Dua të bëhem trajner i Realit

Nga Carlo Ancelotti te Davide Ancelotti, te Reali mund të ketë një rokadë baba-bir për sa i përket stolit të ekipit të bardhë. Por kjo i përket së ardhmes. Ka qenë vetë djali i Carlo Ancelotti, Davide, njëherazi dhe ndihmësi i Carlos në stolin e Madridit, që në një intervistë të dhënë për "France Football", ka shpalosur ambicien e tij për të marrë një ditë drejtimin e Realit të Madridit. "Unë dhe im atë do të vazhdojmë të jemi pjesë e Realit edhe në sezonin e ardhshëm. Madje unë do të qëndroj deri në vitin 2026. Kemi shumë të rinj dhe mundësi për të pasur një ekip shumë të fortë në vitet e ardhshme. Dua ta filloj karrierën time si trajner, por e di që jam në klubin më të mirë në botë. Vendi për t'u rritur nuk ka një datë të caktuar dhe do të varet edhe nga ofertat. Unë jam i lumtur këtu, familja ime jeton këtu, gruaja ime është spanjolle, unë jam afër babait tim... Sfidat nuk më trembin. Qëllimi është të bëhem trajner këtu një ditë", ka deklaruar Davide Ancelotti.

Bayerni, gati kontratën 3 ose 4-vjeçare për Nagelsmannin

Julian Nagelsmann, ish-trajner i Bayern Munchenit dhe trajner aktual i Gjermanisë, mund të kthehet në "Bavari". Sipas asaj që raportohet nga "Sky Sport Deutschland", hipoteza se mund të ulet sërish

në stolin e zënë tani nga Tuchel po bëhet gjithnjë e më konkrete. Tashmë palët po diskutojnë për kontratën, kohëzgjatja e së cilës do të jetë tri ose katër vjet. Megjithatë, Nagelsmanni ende nuk e ka

dhënë "dritën jeshile", po reflekton, nuk e ka pranuar propozimin. Pas refuzimit të Xabi Alonso, i cili do të qëndrojë te Bayer Leverkuseni, klubi me të cilin fitoi Bundesligën këtë sezon,

Bayern Munchen, ka shtuar kontaktet me Nagelsmannin. Eberl dhe Freund filluan dialogun, zhvilluan negociatën me agjencinë "Sports360", e cila kujdeset për interesat e trajnerit në fjalë. Megjithatë,

nuk duhet harruar se janë të vlefshme edhe kandidaturat e Roberto De Zerbi të Brightonit dhe Unay Emery të Aston Villas. Gjithsesi, pa ndonjë surprizë, duket se Nagelsmann do ta fitojë këtë garë speciale.



Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenit 8 par. 4, nenit 11, nenit 21 nën par. 2.2 dhe nenit 25 të Rregullores Nr. 55/21 për Marrëdhënien e Punës të N.P.L "Përparimi" Sh. A. në Vushtri e miratuar me datë 21.12.2021 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L "Përparimi" Sh. A., e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 645/24 të datës 12.04.2024 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L "Përparimi" Sh. A me datë 15.04.2024 shpall:

KONKURS PUBLIK

I. Titulli: Sigurim Fizik - roje

Numri i ekzekutuesve: 2

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit, nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla e Mesme apo fillore

Përvoja e punës: Preferohet gjashtë (6) muaj

I raporton: Udhëheqësit të Njesisë së Sigurimit Fizik

Lartësia e pagës mujore: 390.00Euro Bruto.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryejë detyrat e punës;
- Përkujdeset mbi sigurimin e objektit dhe pasurisë të organizatës, institucionit publik;
- Në rast të ndonjë rreziku lajmëron menjëherë personat kompetent;
- Sipas nevojës mund të caktohet edhe në lokacion tjetër për sigurim fizik;
- Është i obliguar të përdorë të gjitha mjetet e parapara të mbrojtjes në punë;
- Të jetë i aftë që të përdor mjetet kundër zjarrit;
- Për punën që kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë së Sigurimit Fizik;
- Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;

Kushtet e veçanta

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Shkathësi fizike, preferohet të ketë të përfunduar trajnime nga fusha e sigurisë;
- Preferohet të jetë i licencuar në fushën e sigurimit fizik;

Aplikacionit duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen)
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale plotësuese që i ndalon ushtrimin e veprimtarisë, e cila mund të merret edhe në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

II. Titulli: Inkasant

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit, nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi

Përgatitja profesionale: Përgatitje universitare apo shkollë e mesme

Përvoja e punës: Preferohet një (1) vit

I raporton: Mbikëqyrësit të shërbimit të inkasimit

Koeficienti i pagës: 422.00 Euro Brutto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Përfaqësimi dinjitoz i ndërmarrjes para konsumatorëve;
- Dhënia e informatave të sakta lidhur me kohën e kryerjes së shërbimit në zona të caktuara;
- Të ketë aftësi komunikuese dhe sjellje të mira me konsumatorët;
- Të mbajë evidencë me shkrim dhe të njoftojë mbikëqyrësin për çdo ndryshim eventual të amvisërive dhe bizneseve për zonën e caktuar të mbulueshmërisë së tij/saj, si dhe të bëjë kategorizimin e tyre;
- Të lidhë kontrata mbi shërbimet me ekonomitë familjare (amvisëritë), si dhe të njoftojë në kohë reale për hapjen e bizneseve të reja për zonën e caktuar të mbulueshmërisë së tij/saj;
- Pranimi i faturave, shpërndarja e faturave tek konsumatorët, si dhe barazimi në baza ditore sipas inkasimit;
- Për punën e tij i përgjigjet Mbikëqyrësit të shërbimit të inkasimit.

Kushtet e veçanta

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Njohja e programeve Microsoft Office, programet e kontabilitetit;
- Të njoh përdorimin e E-banking – ut dhe aftësi organizative.

Aplikacionit duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen)
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale plotësuese që i ndalon ushtrimin e veprimtarisë, e cila mund të merret edhe në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendrike nga dita e publikimit të të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data 15.04.2024 deri me datë 29.04.2024 në ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 08.05.2024.
- Afati për ankesë nga data 09.05.2024 deri me datë 13.05.2024.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 16.05.2024.
- Afati për ankesë nga data 21.05.2024 deri me datë 24.05.2024.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 30.05.2024.
- Afati për ankesë nga data 03.06.2024 deri me datë 06.06.2024.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu 11.06.2024.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish


objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: hrperparimi@gmail.com.

Njësia e burimeve njerëzore e ndërmarrjes do të ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët lidhur me kriteret e konkursit publik gjatë fazës së aplikimeve.

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen.



U skladu s članom 8, članom 10 stav 2.2 i članom 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljenom u Službenom listu Republike Kosovo dana 01.12.2010. godine, u vezi s članom 6 od 7 Uputstva Administrativnog broj 01/2024 o uređivanju postupaka konkursa u javnom sektoru koji je dio Zakona br. 03/L-212 o radu objavljenog u Službenom listu Republike Kosovo dana 31.10.2017. godine, i članom 8 stav 4, članom 11, članom 21 stav 2.2 i članom 25 Pravilnika br. 55/21 o radnom odnosu NPL „Perparimi“ Sh. A Sh. A. u Vučitrnu, usvojenog dana 21.12.2021. godine od strane Upravnog odbora NPL „Perparimi“ Sh. A“ Sh. A., i uzimajući u obzir odluku sa brojem protokola 647/24 od 12.04.2024. godine od Izvršnog direktora, NPL „Perparimi“ Sh. A. 14.04.2024 objavljuje:

JAVNI KONKURS

I. Naslov: Fizičko obezbeđenje

Broj izvršilaca: 1

Radno vreme: 40 sati nedeljn

Trajanje imenovanja: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja

Stručna priprema: Srednja škola i Osnovna škola

Radno iskustvo: Najmanje šest (6) meseci

Izveštava: Rukovodioci jedinice za fizičko obezbeđenje;

Koeficijent plate: 390.00 Euro Brutto

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Biti sposoban da obavlja radne obaveze sa punim radnim vremešnom i bez ograničenja;
- Stara se o bezbednosti objekta i imovine organizacije, javne ustanove;
- U slučaju bilo kakve opasnosti, odmah obavesti nadležna lica;
- Obavezno je koristiti sva predviđena sredstva zaštite na radu;
- Umetl da koristi opremu za gašenje požara;
- Po potrebi, možete takođe je raspoređen na drugu lokaciju radi fizičkog obezbeđenja;
- Za svoj rad odgovoran je rukovodilac jedinice fizičkog obezbeđenja.
- Obavlja i druge poslove po nalogu uprave preduzeća;

Posebni uslovi:

- Da ste državljanin Republike Kosovo;
- Fizičke sposobnosti, poželjno je imati završenu obuku iz oblasti fizičkog obezbeđenja Favorite;
- Predanost se daje osobama sa licencom u oblasti fizičke sigurnosti.

Uz prijavu je potrebno priložiti sledeće:

- Obrazac za prijavu N.P.L. „Perparimi“ Š. A - Vučitrn.;
- Potvrde o školskoj spremi (skenirane);
- Izvod iz rođenja; (sertifikat izdat online na platformi e-Kosova će biti prihvaćen)
- Uverenje o krivičnoj osudi izdato od strane Sudskog saveta Kosova, da nema dodatnih krivičnih presuda koje zabranjuju obavljanje delatnosti, a koje se takođe mogu dobiti iz centralne kaznene evidencije Republike Kosovo (potvrda izdata onlajn na platforma e-Kosova će biti prihvaćena);
- Dokaz o radnom iskustvu (skenirano) (nije obavezno);
- Kopija lične karte (skenirana);

II. Naslov: Inkasant račun

Broj izvršilaca: 1

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Trajanje imenovanja: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će tri (3) meseca biti probni rad, sa mogućnošću produženja

Stručna priprema: Pripreme za fakultet ili srednju školu

Radno iskustvo: Jedna (1) godina u relevantnoj oblasti

Izveštava: Nadzornici službe naplate

Koeficijent plate: 422.00 Euro Brutto;

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Dostojanstveno predstavljanje preduzeća pred potrošačima;
- Pružanje tačnih informacija u vezi sa vremenom službe u određenim oblastima;
- Imaju komunikacijske veštine i dobro se ponašaju sa kupcima;
- Da vodi pisane evidencije i da obaveštava nadzornika o svakoj eventualnoj promeni domaćinstava i preduzeća za određeno područje njegovog pokrivanja, kao i da ih kategorizuje;
- Da zaključuje ugovore o uslugama sa porodičnim privredama (domaćinstvima), kao i da u realnom vremenu obaveštava o otvaranju novih poslova za određeno područje njegovog pokrivanja;
- Prijem računa, distribucija faktura potrošačima, kao i usaglašavanje na dnevnom nivou prema naplati;
- Za svoj rad odgovara nadzorniku službe naplate.

Posebni uslovi

- Da ste državljanin Republike Kosovo;
- Poznavanje Microsoft Office programa, računovodstvenih programa;
- Znanje korišćenja elektronskog bankarstva i organizacione veštine.

Uz prijavu se mora priložiti sledeće:

- Obrazac za prijavu N.P.L. „Perparimi“ Š. A - Vučitrn.;
- Potvrde o školskoj spremi (skenirane);
- Izvod iz rođenja; (sertifikat izdat online na platformi e-Kosova će biti prihvaćen)
- Uverenje o krivičnoj osudi izdato od strane Sudskog saveta Kosova, da nema dodatnih krivičnih presuda koje zabranjuju obavljanje delatnosti, a koje se takođe mogu dobiti iz centralne kaznene evidencije Republike Kosovo (potvrda izdata onlajn na platforma e-Kosova će biti prihvaćena);
- Dokaz o radnom iskustvu (skenirano) (nije obavezno);
- Kopija lične karte (skenirana);

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja istog. Objava je otvorena od datuma 15.04.2024. do datuma 29.04.2024. u 16:00 sati.

Ovaj javni konkurs je otvoren, ali pravo prijave imaju samo osobe sa invaliditetom.

Približni kalendar postupka regrutacije:

- Preliminarna verifikacija prijava kandidata najkasnije do datuma 08.05.2024.
- Rok za žalbe od datuma 09.05.2024. do datuma 13.05.2024.
- Period kada će kandidati biti podvrgnuti pisanim testovima i ocenjivanju najkasnije do datuma 16.05.2024.
- Rok za žalbe od datuma 21.05.2024. do datuma 24.05.2024.
- Period kada će kandidati biti podvrgnuti usmenom intervjuu i ocenjivanju najkasnije do datuma 30.05.2024.
- Rok za žalbe od datuma 03.06.2024. do datuma 06.06.2024.
- Objavljivanje konačnih rezultata u vezi sa uspešnim kandidatom najkasnije do 11.06.2024.

Zainteresovani kandidati mogu preuzeti formular za prijavu u Arhivskoj kancelariji NPL „Perparimi“ Sh. A u gradu Vučitrn, ul. „Gjergj Kastriot Skënderbeu“ br. 82, (bivša zgrada TMK-a blizu Osnovnog suda Mitrovica - ogranak u Vučitrnu) svakog 08:00 od 16:00.

Dostava aplikacije sa svom traženom dokumentacijom u ovom javnom obaveštenju mora se obaviti isključivo putem elektronske adrese kako sledi: hrperparimi@gmail.com.

NPL "Perparimi Sh. A. u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo.

Jedinica ljudskih resursa preduzeća će pružiti potrebna objašnjenja kandidatima u vezi sa kriterijumima javnog konkursa tokom faze aplikacija.

Sva komunikacija tokom postupka javnog konkursa će se odvijati putem elektronske komunikacije.

Napomena: Prijava predana nakon predviđenog roka se neće razmatrati.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar Laboratori mikrobiologjik “ALPHA-LAB” SH.P.K. me seli në Fushë Kosovë, Bresje ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810169872 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa Laboratori mikrobiologjik “ALPHA-LAB”D.O.O. Fushë Kosovë, Bresje, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810169872 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability Laboratori mikrobiologjik “ALPHA-LAB”L.L.C. with headquarters Fushë Kosovë, Bresje, has come to the decision to quit its business: 810169872 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “ATOZ SOLUTIONS” SH.P.K. me seli në Prizren ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811934125 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “ATOZ SOLUTIONS” D.O.O. u Prizren, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811934125 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “ATOZ SOLUTIONS” L.L.C. Prizren with headquarters has come to the decision to quit its business: 811934125 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Ambulanca Neuropsikiatrike “Mens Sana” shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70933225.

- Trim Ademi shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811928481, parku lounge sh.p.k.

- Qerime Kelmendi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu “ Leke Dukagjini “ Prizren.

- Jeton Korllari shpall te pavlefshme 2 dëftesat dhe diplomën Q.K. “11 Marsi “ Prizren.

- Razije Cocaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Leke Dukagjini “ Prizren.

- Jeton Korllari shpall te pavlefshme 2 dëftesat shme “ Ymer Prizreni “ Prizren.

- Ramiz Shala nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Akademis Pedagogjike “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

